

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5972
E premte, 10 janar 2020
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Kosovës
ende i duhet mbështetja
e Gjermanisë për
anëtarësim në mekanizma
ndërkombëtarë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI | FAQE 4-5

NËSE SHKOHET NË ZGJEDHJE TË REJA, PAN-i NË QEVERI E LV E LDK NË OPOZITË

Analisti politik Ramush Tahiri ka fajësuar Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) për bllokim të marrëveshjes për bashkëqeverisje me Lëvizjen Vetëvendosje (LV). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është e padrejtë që kjo parti t'i kërkojë shtatë ministri ose t'i kthehet

postin e kryeparlamentarit dhe pesë ministri. Tahiri ka deklaruar se nëse nuk ka marrëveshje LV - LDK presidenti duhet ta mandatojë Albin Kurtin për kryeministër edhe pa propozim formal të LV-së. Ai ka treguar se presidenti këtë mund ta bëjë duke u thirrur në konsultimin që ka pasur me të dhe në videomesazhin që Kurti ka

publikuar në "Facebook", përmes të cilit ka treguar se është kandidat i LV-së për kryeministër dhe ka propozuar ministrat e subjektit të tij. Tahiri ka thënë se nëse shkohet në zgjedhje të reja, PDK-ja bëhet bashkë me Nismën mund të dalë e para dhe PAN-i mund të vijë në qeveri dhe LV-ja e LDK-ja të kalojnë në opozitë

EDHE TË ENJTEN JANË TAKUAR LIDHJA E LËVIZJES VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI DHE
AI I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (LDK), ISA MUSTAFA

GJASAT JANË TË VOGLA QË TË NDODHË MARRËVESHJA LV - LDK



Pazari për ndarjen e 'kulaçit' të pushtetit po del të jetë problemi kryesor për mosarritjen e një marrëveshjeje për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). As të enjten liderët e këtyre dy partive, Albin

Kurti dhe Isa Mustafa, nuk kanë arritur ujdin për një marrëveshje LV - LDK për formimin e qeverisë të dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit. Ndërkaq në takimin e së mërkurës u tha, nga të dyja palët, se janë afër marrëveshjes, e kjo nuk ndodhi as të enjten | FAQE 3

Rama: Kryesimi i OSBE-së, ditë historike për Shqipërinë



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION



LAMTUMIRË XHEVAT

Ismet SYLEJMANI

BETEJA E PERANIT, BETEJË E KRENARISË SË LUFTËS SË UÇK-së

Shkruan:
Ylber ÇITAKU



AKTUALE

JAHJAGA DHE TËRNAVA NË MESIN E 500 PERSONALITETEVE MË ME NDIKIM NË BOTËN ISLAME

GJYKATA SPECIALE FTON DEPUTETIN E PDK-së, FERAT SHALA

EKONOMI

2019-a, VITI MË I SUKSESSHËM DERI TASH PËR AEROPORTIN E PRISHTINËS

EKSPORTI SHËNOI RITJE PËR 9 PËR QIND

SPORT

GASHI: BESA RIKTHEHET NË SUPERLIGË

Biberaj: Rama të mos e vë presidencën e OSBE-së në shërbim të Vuçiqit

TIRANË, 9 JANAR - Pak orë pasi kryeministri Edi Rama, njëherësh dhe ministër i Jashtëm i vendit, shpali nga Vjena objektivat e Shqipërisë në drejtimin e presidencës së OSBE-së, ish-deputeti demokrat, Aleksandër Biberaj thotë se Rama duhet ta shfrytëzojë këtë moment në funksion të Kosovës. I ftuar në intervistën në Ora Neës, ish-zëvendës-presidenti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, porosi kryeministrin të mos e vendos

presidencën e OSBE-së në shërbim të presidentit serb Aleksandër Vuçiq. "Duke pasur presidencën e OSBE-së si një faktor i rëndësishëm vendim-marrës mund të bëjmë shumë gjëra të mira për Kosovën por jo ta vendosim presidencën e OSBE-së në shërbim të Vuçiqit. Do të ishte ekstremi i anti-shqiptarizmit", deklaroi Biberaj.

Shqipëria thotë Biberaj, duhet të jetë shumë e kujdesshme në raport me politikën e Kosovës, me interesat tona atje, sepse

nuk kemi as kapacitetin e as politikanë që t'i shërbejnë kësaj çështje. "Mbroje me dinjitet. Nuk mundet kurrsesi kryeministri i Shqipërisë që të përpiqet që të bëjë faktor politik Vuçiqin i cili është pasardhës i Millosheviqit, jo se nuk ka kërkuar falje për krimet në Kosovë por ka mbrojtur masakrën e Raçakut. Dhe nuk ke pse i shërben, pse e nxjerr nga një izolim. Ne nuk mund të bëhemi përkrah tyre, përkrah Vuçiqit kundër Kosovës për interesat e tua politike", tha ai.



Rama: Kryesimi i OSBE-së, ditë historike për Shqipërinë

Kryeministri Edi Rama tha se "kryesimi i OSBE-së është një ditë historike për Shqipërinë, pasi është dita e parë në historinë e saj që ka një rol në skenën ndërkombëtare dhe për çdo shqiptar që e di rrugën e gjatë që na duhej të arrinim deri këtu kjo është një arsye që ne të jemi krenarë"

TIRANË, 9 JANAR - Kryeministri Edi Rama, në një konferencë të për-bashkët për shtyp me Sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së në Vjenë, Thomas Greminger, tha se "nuk jam këtu të krijoj probleme, por që të zgjidh probleme". I pyetur mbi krizën në Ukrainë, Rama deklaroi se si kryesues i OSBE-së do të punoj që kjo krizë mes dy vendeve të mos thellohet. "Dua të theksoj atë që thashë në hyrje të kësaj konference shtypi, që si kryesues i OSBE-së unë nuk dua të shpreh qëndrime, pikëpamje e mendime të cilat mund të jenë të natyrshme kur flas si kryeministër i Shqipërisë dhe në emër të qeverisë shqiptare, por në këtë pozitë që jam, si kryesues i OSBE-së, kjo nuk është e mundur", tha Rama.

Rama tha se kjo është një ditë historike për Shqipërinë, pasi është dita e parë në historinë e saj që ka një rol në skenën

ndërkombëtare. "Për çdo shqiptar që e di rrugën e gjatë që na duhej të arrinim deri këtu kjo është një arsye që ne të jemi krenarë. Sot përcaktuam prioritetet tona për vitin në vazhdim. Theksuam vendosmërinë për t'u përqendruar në parimet themelore. Ne nuk do të shikojmë që të rishpikim botën, apo ndonjë gjë të re në lidhje me këtë organizatë, por të sigurohemi që gjatë këtij viti parimet themelore, baza do të ngelen ashtu siç janë dhe nuk do të prishen nga disa erëra që janë mjaft rrezikuese në botën ku jetojmë", shtoi ai. "Moszbatimi i parimeve kryesore bazë të Helsinkit dëmton integritetin e vetë OSBE-së, sepse mund të dobësojë demokracitë dhe mund të sjellë rreziqe të papranueshme për qytetarët. Pika e tretë është të ndërtojmë stabilitet përmes dialogut", tha Rama.



Ai shtoi se "si kryetar i OSBE-së, bashkë me Sekretarin dhe gjithë të tjerët, detyra ime është të nxis sa më shumë të jem e mundur që të kemi dialog dhe mënyrën si do ecim para që të garantojmë paqe". "Është e qartë që kriza në Ukrainë dhe rreth saj është një sfidë mjaft e madhe sigurie në Evropë. Prioriteti ynë bazë është të mbështesim punën e Misionit, të punojmë me Përfaqësuesin Special që sapo u caktua, dhe në të njëjtën kohë të jemi sa më të dobishëm që të jetë e mundur që të dyja palët të afrohen drejt një konkluzioni pozitiv. Të gjithë e dimë që kështu duhet të jetë. Nuk është pa arsye që kam vendosur të bëjë vizitën time të parë

në Ukrainë. Jam fuqimisht i angazhuar për të bërë më të mirën time që kjo krizë që ka vazhduar për më shumë se 6 vjet mos të përshkallëzohet më tutje dhe nga tjetër të vazhdojë zbatimin i plotë të Marrëveshjes së Minskut, atë kemi si bazë dhe është njohur gjithashtu si e tillë nga të dyja palët", - tha Rama. I pyetur se përse nuk përmendi Krimenë, Rama tha se "e kam thënë dhe e përsëris edhe një herë, që ne duhet të shikojmë të gjitha mënyrat e mundshme që të sjellim të gjitha palët afër njëra-tjetrës". "Si qeveri dhe si Shqipëri ne kemi qenë të hapur për çështjen e pyetjes, por si kryesues i OSBE-së nuk dua të

jem kaq i hapur, sepse nuk do të kisha rezultatet e duhura, se si kjo organizatë me 57 anëtarë, me ide të ndryshme të arrijë një konkluzion më të shpejtë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Nuk jam këtu të krijoj probleme, por që të zgjidh probleme", - tha Rama.

Duke folur për prioritetet, Rama tha se sfida jonë është të fokusohemi te parimet elementare, bazike.

Kryeministri Rama gjatë fjalës së mbajtur të tij si drejtues i OSBE-së, ka reaguar dhe për deklaratën e diktatorit iranian Ali Khamenei, i cili përmendi të mërkurën një 'vend djallëzor në Evropë që ka bërë komplot me ShBA-në kundër Iranit', duke nënkuptuar Shqipërinë.

Kryeministri Rama theksoi se Shqipëria ka marrë një risk me strehimin e opozitës iraniane në Tiranë, por paralajmëroi dhe sulm ndaj Shqipërisë do jetë sulm ndaj NATO-s. Edhe në konferencën e shtypit të Edi Ramës me Thomas Greminger, sekretar i përgjithshëm i OSBE-së, kryeministri shqiptar theksoi se goditja ndaj Shqipërisë prej Iranit mbetet sulm ndaj NATO-s.

Holanda ka dy kërkesa për Shqipërinë

TIRANË, 9 JANAR - Kroacia ka marrë Presidencën e Bashkimit Evropian dhe për gjashtë muaj do të ketë në fokus kryesor edhe hapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Por është sërish Holanda që kërkon më shumë rezultate nga dy vendet ballkanike.

Në një intervistë për kroaten "Jutarnji", Stef Blok, ministër i Jashtëm i Holandës, ka deklaruar se vendi i tij

mbështet anëtarësimin e Tiranës dhe Shkupit, por duhen më shumë rezultate në sundimin e ligjit, ka njoftuar tch. Blok ka theksuar se nga Shqipëria kërkohet angazhim i qëndrueshëm në luftën kundër korrupsionit dhe kriminit të organizuar. "Verifikimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve është veçanërisht thelbësor. Ka pasur reforma të rëndësishme ligjore dhe janë krijuar institucione të

reja të drejtësisë. Sidoqoftë, përpara fillimit të negociatave të pranimit, Shqipëria do të duhet të tregojë një angazhim të qëndrueshëm për të luftuar korrupsionin dhe kriminit të organizuar", është shprehur Blok.

Në maj të 2020-s Kroacia do ta organizojë samitin e Ballkanit Perëndimor ku pritet të përcaktohet e ardhmja e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në raport me Bashkimin Evropian.



Edhe të enjten janë takuar lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa

Gjasat janë të vogla që të ndodhë marrëveshja LV - LDK

Pazari për ndarjen e 'kulaçit' të pushtetit po del të jetë problemi kryesor për mosarritjen e një marrëveshje për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). As të enjten liderët e këtyre dy partive, Albin Kurti dhe Isa Mustafa, nuk kanë arritur ujdë për një marrëveshje LV - LDK për formimin e qeverisë të dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit. Ndërkaq në takimin e së mërkurës u tha, nga të dyja palët, se janë afër marrëveshjes, e kjo nuk ndodhi as të enjten



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 JANAR - Sërish të enjten në objektin e Kuvendit të Kosovës janë takuar lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa. Por edhe ky takim nuk ka sjellë marrëveshje për bashkëqeverisje. E veçanta e këtij takimi që ka zgjatur rreth dy orë ishte se askush nga zyrtarët e këtyre dy partive nuk është deklaruar për media pas takimit. Ndërkaq në takimin e së mërkurës u tha, nga të dyja palët, se janë afër marrëveshjes, e që nuk ndodhi as të enjten.

Merret vesh se LDK-ja nuk ka pranuar që ministritë të ndahen 6 me 4 pasi që tashmë kërkohet shtatë ministri dhe postin e presidentit. Lëvizja Vetëvendosje ka ofruar vetëm Ministrinë e Punëve të Jashtme, ndërsa LDK-ja ka kërkuar edhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka reaguuar përmes një njoftimi për media në lidhje me ecurinë e takimit të së enjtes me Lëvizjen Vetëvendosje. Sipas kësaj partie, të gjitha supozimet

dhe hipotezat që po qarkullojnë sonte nëpër medie rreth diskutimeve të sotme në mes të LDK-së dhe LV-së janë të pavërteta. "Të gjitha supozimet dhe hipotezat që po qarkullojnë sonte nëpër medie rreth diskutimeve të sotme në mes të LDK-së dhe LV-së janë të pavërteta. LDK-ja në mirëbesim dhe me vullnet për të arritur marrëveshje i ka paraqitur ofertën LV-së për bashkëqeverisje", është thënë në njoftimin e LDK-së.

Për takimet e negociatave në mes të LV-së dhe LDK-së kanë folur Hekuran Murati dhe Bajram Gecaj. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati, ka thënë se kjo parti nuk insiston në ministri e poste për të rehatuar emra të përveçëm por, sipas tij, për shkak të funksionit që ato poste bartin, e që janë kryesore drejt përmbushjes së obligimeve që kanë marrë si LV karshi votuesve. "Se nuk e kemi për poste e pushtet, besoj u vërtetua me emrat e kabinetit Kurti, që dy nga ta janë emra jashtë Lëvizjes. Synimi ynë është që të krijojmë një qeveri e cila është funksionale dhe nxjerr vendin nga humnera. Çdo ngutje dhe lëshim pe në këtë aspekt, e zhbën edhe vetë qëllimin e

fitores së 6 tetorit. E kuptoj se shumë prej jush e prisni me padurim krijimin e qeverisë së re. Të gjithë po e presim. Por nuk duhet që dëshira e sinqertë për formim sa më të shpejtë të qeverisë të na nxitojë drejt një marrëveshjeje të keqe", ka shkruar Murati në logarinë e vet në "Facebook".

Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Bajram Gecaj, ka reaguuar pas takimit të së enjtes mes kryetarit të LDK-së, Isa Mustafa, dhe kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. Gecaj ka thënë se LDK-ja është kalitur dhe formuar në frymën shtetformuese, edhe pse janë munduar ta zbehin rolin dhe rëndësinë e kësaj partie. "Anëtarësia dhe votuesit e LDK-së, pos që janë emancipuar, tani e tridhjetë vjet radhazi edhe janë kalitur e stërkalitur nën kredon dhe frymën nacionale e shtetformuese. Janë munduar ta zbehin rolin dhe rëndësinë e lidhjes shumëkush dhe me shumë mjete, përfshirë vrasjet e aktivistëve më të mirë dhe më të devotshëm, por pas secilës betejë jemi rikthyer si 'feniksi nga hiri', të fortë dhe shumë të qën-

drueshëm", ka shkruar Gecaj në logarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shtuar se këta që tentuan ta zbehin këtë rol nuk do të arrijnë ta gjuhëzojnë idenë e lirisë, pavarësisë e demokracisë. "Nuk ia arritën atëherë dhe nuk do t'ia arrijnë as sot e as kurrë, ta gjuhëzojnë idenë e lirisë, pavarësisë e demokracisë, të formësuar dhe të mishëruar thellë në ADN-në e LDK-së! Zgjedhjet nuk janë ideuar si një formë psiko-shkencore e eksperimentimit me vullnetin e popullit, por si besim i dhënë dhe obligim i pranuar për ta udhëhequr vendin në emër dhe për të mirën e qytetarëve. Kushdo që abuzon (eksperimenton) me këtë besim do të përfundojë atje ku e ka vendin, në harresën e historisë", ka thënë Gecaj.

Takimet në mes të LV-së dhe LDK-së po i përcjellin edhe zyrtarët e PDK-së dhe AAK-së, të cilët kanë dhënë vlerësimet e tyre në rrjetet sociale. Bujar Cakolli, anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së, duke komentuar takimin e së enjtes në mes të Kurtit dhe Mustafës, ka thënë se marrëveshja LV-LDK dështoi.

Ndërkaq anëtari i Kryesisë së AAK-së, Muharrem Nitaj, ka

thënë se mosmarrëveshjet midis LV-së dhe LDK-së duket se janë më të thella sesa një post presidenti apo ministri, ose janë shumë më serioze sesa kaq. "Është pak e besueshme që LDK-ja të ngulë këmbë për kaq pak, por problemi mund të jetë diku tjetër. Me gjasë shumë në LDK nuk janë të gatshëm ta pranojnë rolin e një partneri të nënshtruar, për të mos thënë të poshtëruar në një qeveri Kurti. Ky i fundit tashmë i ka ndër marrë disa veprime që mund të kuptohen edhe si përpjekje për nënshtrimin e partnerit, sado që nuk e ka fare problem t'i ndërrojë qëndrimet edhe në çastet e fundit. Te vëmendshmit mund ta vërejnë se Albin Kurti po shpërfaq synime më të mëdha sesa postin e kryeministrit të Kosovës. Me gjasë atij i është mbushur mendja për rrugën e një lideri panshqiptar, nëse ia rrokë, natyrisht. Dhe nuk përjashtohet që në përpjekje për të marrë gjithçka, të mbetet pa asgjë, ose që grupi i interesshinjeve brenda LDK-së, mos të shohë asgjë përtej posteve ministrorë dhe mandatit të deputetit, dhe ta pranojë një marrëveshje sado e pafavorshme qoftë ajo për LDK-në", ka thënë Nitaj.

Gjykata Speciale fton deputetin e PDK-së, Ferat Shala



PRISHTINË, 9 JANAR (ER) - Gjykata Speciale ka ftuar për intervistim deputetin e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Ferat Shala. Lajmin e ka bërë me dije Shala në një njoftim në logarinë e vet në "Facebook". Ai ka treguar se do t'i përgjigjet ftesës më 5 shkurt të këtij viti. "Të nderuar qytetarë të Republikës

së Kosovës, dua t'ju informoj se kam pranuar ftesë nga Gjykata Speciale në Hagë, të cilës do t'i përgjigjem më datë 05. 02. 2020. Në tërë veprimtarinë time jetësore atdhetare asnjëherë nuk jam ndier më i nderuar dhe respektuar sesa kur isha pjesë e UÇK-së. Asnjë shkronjë nuk e heq nga e kaluara ime në të

gjitha periudhat e veprimtarisë sime. Me këtë rast, dua ta falënderoj trugun tim familjar që më edukoi në rrugën e drejtë karshi popullit dhe atdheut tim. Shpreh falënderim dhe mirënjohje për të gjithë bashkëlloftëtarët, dëshmorët dhe heronjtë për sakrificën sublime që ata bënë", ka shkruar Shala.



FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI

NËSE SHKOHET NË ZGJEDHJE TË REJA, PAN-I NË QEVERI E LV E LDK NË OPOZITË

Analisti politik Ramush Tahiri ka fajësuar Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) për bllokim të marrëveshjes për bashkëqeverisje me Lëvizjen Vetëvendosje (LV). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është e padrejtë që kjo parti t'i kërkojë shtatë ministri ose t'i kthehet posti i kryeparlamentarit dhe pesë ministri. Tahiri ka deklaruar se nëse nuk ka marrëveshje LV - LDK presidenti duhet ta mandatojë Albin Kurtin për kryeministër edhe pa propozim formal të LV-së. Ai ka treguar se presidenti këtë mund ta bëjë duke u thirrur në konsultimin që ka pasur me të dhe në videomesazhin që Kurti ka publikuar në "Facebook", përmes të cilit ka treguar se është kandidat i LV-së për kryeministër dhe ka propozuar ministrat e subjektit të tij. Tahiri ka thënë se nëse shkohet në zgjedhje të reja, PDK-ja bëhet bashkë me Nismën mund të dalë e para dhe PAN-i mund të vijë në qeveri dhe LV-ja e LDK-ja të kalojnë në opozitë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 JANAR -

"Epoka e re": Z. Tahiri, as takimi i tretë i kësaj jave në mes të LV-së dhe LDK-së nuk ka sjellë ndonjë marrëveshje. Cili është koment i juaj?

Tahiri: Është keq që nuk po ka rezultat për arritjen e mar-

rëveshjes për koalicion në mes të LDK-së dhe LV-së. Edhe më keq është që nuk po bëhen publike dallimet se për çka nuk po arrihet kjo marrëveshje. Opinioni me të drejtë ose pa të drejtë po konsideron se LDK-ja me kërkesat për shtatë ministri faktikisht po e bllokoi procesin e marrëveshjes, sepse po i vendos në pozitë shumë të keq


Albin Kurtin dhe LV-në. Se a është e vërtetë që LDK-ja po i kërkon shtatë ministri këtë do ta dimë nëse marrëveshja nuk arrihet përfundimisht, sepse atëherë palët duhet të tregojnë se ku i kanë pasur dallimet.

"Epoka e re": Sipas jush, si do të duhej të ndaheshin postet?

Tahiri: Meqenëse LV-ja është

partia e parë, konsideroj se posti i kryeministrit me automatizëm i takon asaj, kurse dhjetë ministritë e tjera duhet të ndahen 5 me 5. Se cila nga këto ministri është më e rëndësishme i mbetet të zgjedhë LDK-së, meqenëse ajo po shihet se është më e pakënaqur. Ndërsa kryeparlamentari me Kushtetutë i takon LV-së dhe nuk bartet te partia e dytë. Për

mua ka qenë komplet e padrejtë juridikisht dhe politikisht kërkesa e LDK-së për ta marrë kryeparlamentarin për ta bërë pjesë të ndarjeve kushtetore, sepse kryesia e Kuvendit ndërtohet për balancë të forcave. Do të ishte e turpshme nëse del që marrëveshja nuk është arritur për një post ministror ose dy poste ministore. Edhe më e turpshme do të jetë



profilin e vet në "Facebook" është deklaruar se është kandidat i LV-së për kryeministër. Në atë videomesazh ai ka thënë se si kandidat për kryeministër i LV-së i ka propozuar ata emra për ministra nga subjekti që drejton. Një veprim i tillë është pranë se është kandidat për kryeministër, pra me videomesazh dhe me shkrim ai deklarohet. Mendoj se tani Thaçi nuk ka nevojë të konsultohet se kush do të jetë kandidat për kryeministër nga LV-ja. Presidenti Thaçi, nëse e dekreton Kurtin për kryeministër duke u thirrur në këtë videomesazh dhe duke u thirrur në konsultimin që ka pasur me të, sipas nenit 95 të Kushtetutës, mund ta nominojë Kurtin për kryeministër.

"Epoka e re": Por LV-ja përmend nënin 84 të Kushtetutës, duke thënë se kjo parti duhet ta propozojë me anë të një shkrese z. Kurti për kryeministër?

Tahiri: Natyrisht se neni 84 thotë se me propozim të Vetëvendosjes, por tani propozimi i LV-së është se Albin Kurti e ka propozuar vetveten në videomesazhin në "Facebook" ku u tregoj të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe LDK-së se ai ka caktuar pesë ministrat e tij, ndërsa ka ftuar partnerin e tij politik t'i propozojë pesë emra të tjerë. Nëse presidenti Thaçi sot e nxjerr këtë dekret, z. Kurti nga sot i ecën 15-ditëshi i paraparë në Kushtetutë. Për mua është e pandershme që z. Kurti po refuzon ta marrë nominimin, duke thënë se presidenti e di që nuk ka marrëveshje. Presidentit nuk i intereson nëse ka marrëveshje apo jo. Presidentit i intereson vetëm a je ti kandidat i partisë së parë. Se a ke marrëveshje apo jo, ajo duhet të dëshmohet në Kuvend, jo te presidenti. Nëse presidenti e dekreton kandidatin për kryeministër, z. Kurti brenda 15 ditësh duhet të shkojë në Kuvend dhe nëse i merr votat e mjaftueshme zgjedhet kryeministër, nëse nuk i ka votat bie. Por, nëse ai refuzon dhe nuk shkon në Kuvend për t'u votuar, kjo merret sikur e ka konsumuar të drejtën dhe nuk është zgjedhur. Pastaj, presidenti Thaçi brenda afatit tjetër e cakton kandidatin tjetër për kryeministër. Jo prej të njëjtës parti, jo prej partisë së dytë, apo të tretë, por prej kujt dëshiron ai. Domethënë ai e vlerëson se kush i ka numrat. Në këtë fazë, prapë mundet që PAN-i të jetë në qeveri. Shembull, nëse i jepet rasti PDK-së dhe ajo i bën numrat, atëherë në opozitë mbeten LDK-ja dhe LV-ja. Në këtë mënyrë Kosova do të kishte përsëri një qeveri nga partitë që kanë qeverisur mandatin e kaluar. Pra, edhe kandidati i dytë për kryeministër i ka 15 ditë afat për ta formuar qeverinë e re. Nëse Kurti e konteston nominimin e Thaçit dhe e dërgon në Kushtetuese, besoj se në një periudhë të shpejtë Gjykata

nëse arrihet marrëveshja dhe LDK-ja do t'i ketë shtatë ministri, duke thënë se dihet çfarë peshe ka posti i kryeministrit. Pra, kryeministri nuk ka sektor, ai punon përmes ministrave. Nuk e di pse thonë ata se kryeministri vlen sa tre ministra. Ai në qeveri e ka një votë. Nëse dakordimi do të kishte një marrëveshje ku LDK-ja do t'i ketë shtatë ministri, LV-ja tri dhe minoritetet dy, kjo do të ishte një absurd i madh.

"Epoka e re": Domethënë, LV-ja e ka pranuar formulën 6 me 4?

Tahiri: LDK-ja, sipas burimeve të mia, nuk po e pranon as ofertën 6 me 4. Ajo po i dëshiron shtatë ministri. Sepse LV-ja është pajtuar me formulën 6 me 4, por LDK-ja po dëshiron më shumë. Ose është formula tjetër që po e kërkon LDK-ja, qeveria të ndahet 5 me 5, të japë dorëheqje Glauk Konjufca nga posti i kryeparlamentarit dhe ky post t'i takojë LDK-së. Gjithashtu, LDK-ja kërkon zotimin për president. Për mendimin tim, do të ishte e turpshme që z. Konjufca të jepte dorëheqje.

"Epoka e re": Si duhet të veproj nëse këto parti nuk arrijnë një marrëveshje? Çfarë duhet të bëjë presidenti tani?

Tahiri: Mendoj se presidenti Hashim Thaçi duhet ta nominojë Albin Kurtin për kryeministër sepse Albin Kurti përmes videomesazhit të publikuar në

HAZIRI: POZITA E PRESIDENTIT ISHTE PËR TA SHMANGUR KRIZËN POLITIKE

PRISHTINË, 9 JANAR - Nënkrjetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, në "Rubikon" të KTV-së ka thënë se nuk është kryer marrëveshja me Vetëvendosjen, derisa ka theksuar se çështja e presidentit ishte për ta shmangur një krizë politike. Ai ka thënë se tani çështja e kryetarit të Kuvendit është problem, derisa thekson se duhet të sqarohen të gjitha çështjet deri në fund në mënyrë që të arrihet marrëveshja finale. "Krejt këto parime që i kemi vendosur vetë ndoshta u japin vështirësi bisedimeve pasi nuk kemi opsione të tjera (për të bërë koalicion me të tjera parti). Kryetari i Kuvendit është problem. Në nivel ekzekutiv duhet të sqarohen deri në fund. Sikur të mund të arrinim deri te një zgjidhje finale. Ne jemi duke vazhduar të trajtojmë çështje të tjera që janë në vijën e njëjtë

me përgjegjësitë që kemi", ka thënë Haziri.

Ai thotë se çështja e presidentit mund të jetë problem në marsin e vitit të ardhshëm, pasi potencialisht edhe mund të shkohet në zgjedhje. "Pesë javë na kanë mbajtur për çështjen e presidentit. Ne po tentojmë të sqarojmë me i zbardhë të gjitha përgjegjësitë tona. Është shumë e rëndësishme se kush kanë me qenë implementues. Në mars të vitit të ardhshëm ose duhet me e zgjedhë presidentin, ose e merr opozita, ose shkojmë në zgjedhje", ka thënë Haziri.

Ai thotë se derisa nuk ka marrëveshje finale atëherë nuk vlen asnjë marrëveshje e deritanishme. "Përveç që nuk është përfunduar marrëveshja, në parim jemi pajtuar. Përdërisa nuk ka marrëveshje finale nuk vlen asnjë pjesë e marrëveshjes. Ne e kemi votuar

kreun e Kuvendit, pse duhet ta komentojmë një votë që LDK-ja e ka kryer. Ajo është kryer njëanshëm dhe pa marrëveshje. Tash partnerët nuk mund të kenë implementim të njëanshëm të marrëveshjes pa dokument. Marrëveshja nuk është punë e kryer. Është kryer një punë e procesit, mandej Kuvendi e ka punën për ta zgjedhë Qeverinë", u shpreh Haziri.

Haziri insiston se tani LDK-ja nuk e ka asnjë pozitë të rëndësishme, pasi LDK-ja ka marrë kryeparlamentarin dhe kryeministrin. Ai thekson se LDK-ja nuk është trampolinë për partitë e tjera. Ai ka shtuar se pa LDK-në nuk ka zgjedhje e as zgjidhje në Kosovë. Haziri ka thënë se zgjedhjet e reja nuk janë opSION. "Besoj se ka kapacitete dhe vullnet për ta përballuar këtë marrëveshje", është shprehur Haziri.



Kushtetuese do t'i japë të drejtë Hashim Thaçit. Një parti që i ka 25 për qind të votave nuk mund ta çojë vendin në zgjedhje. Vendin në zgjedhje e çojnë vetëm 61 deputetë.

"Epoka e re": Cilës parti do t'i konvenonin zgjedhjet e reja?

Tahiri: Nëse vendi shkon në zgjedhje mendoj se penalizohet LDK-ja, sepse më nuk mund t'i nxjerrë kandidatët për deputetë ashtu siç ka bërë

herën e fundit dhe më nuk mund ta nxjerrë një kandidat konsensual për kryeministër ashtu siç e ka pasur. Po ashtu, nëse shkohet në zgjedhje dhe nëse PAN-i bëhet bashkë, atëherë LDK-së nuk do t'i vijë radha të hyjë në qeveri. Mendoj se zgjedhjet për LV-në do të ishin të favorshme. Nuk besoj se humb kjo parti, sepse i ka bërë të gjitha përpjekjet për ta bërë qeverinë dhe nëse kjo parti do të akuzonte LDK-në se ka

kërkuar dy ministri më shumë, atëherë opinionin do të nervozojë më shumë kundër LDK-së dhe jo LV-së. LV-ja do të ketë hendikep sepse do të shkojë e vetme në zgjedhje dhe do ta ketë problem të rritet për disa deputetë. Ndërsa, në zgjedhje të reja PDK-ja me Nismën mund të shkojnë bashkë dhe ekziston mundësia që të dalin partia e parë dhe të ndodhë ajo që kemi parë mandatin e kaluar: PAN në qeveri dhe LV e LDK në opozitë.

Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës mbështet SBASHK-un lidhur me Ligjin e pagave

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 JANAR - Komiteti i Sindikatës Evropiane të Arsimit (ETUCE), me seli në Bruksel, është informuar nga SBASHK-u lidhur me situatën e re në sektorin e arsimit të Kosovës pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila, duke mbështetur kërkesën e Avokatit të Popullit, pezulloi Ligjin e pagave deri më 30 mars të këtij viti. Në komunikatën për media të SBASHK-ut theksohet se janë duke përcjellë shqetësimin e thellë dhe zhgënjimin e arsyeshëm të anëtarësisë që ishte në pritje tani e nëntë muaj për implementimin e Ligjit të pagave dhe në lidhje me këtë e

kanë informuar ETUCE-n se në gjithë shoqatat sindikale janë duke u mbledhur nënshkrime të cilat po i dorëzohen Qeverisë së Kosovës dhe Avokatit të Popullit me kërkesën që ata, duke respektuar kërkesën legjitime të mijëra punëtorëve të arsimit, t'i drejtohen Kushtetueses me kërkesën që ta revokojë vendimin për masën e përkohshme të pezullimit të Ligjit të pagave.

Komiteti i Sindikatës Evropiane të Arsimit përmes drejtoreshës së Përgjithshme Suzan Flocken i është drejtuar me një letër presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, Avokati të Popullit, Hilmi Jashari dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke kërkuar që ata ta kenë parasysh këtë kërkesë



legjitime të punëtorëve të arsimit dhe duke kujtuar edhe një herë se Komiteti i Sindikatës Evropiane për Arsim (ETUCE), që përfaqëson 132 sindikata arsimore, gjegjësisht 11 milionë mësues në Evropë, është në

mbështetje të SBASHK-ut. "Organizata jonë anëtare, SBASHK-u, ka përcjellë shqetësimin e thellë për vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të 12 dhjetorit 2019, që është dhënë në

bazë të kërkesës së Avokatit të Popullit të Kosovës dhe që pezulloi përkohësisht Ligjin e Pagave të Sektorit Publik deri më 30 mars 2020. Pas kësaj, ETUCE i shpreh mbështetje SBASHK-ut dhe ju kërkon të filloni bisedimet që përfshijnë kryeministrin në detyrë dhe të gjithë drejtuesit e partive politike për të diskutuar alternativat e mundshme për alokimin e 25 për qind të rritjes së pagave, siç u përcaktua fillimisht nga Ligji i pagave të sektorit publik. Ju sigurojmë se do të vazhdojmë t'i vëzhgojmë nga afër zhvillimet", thuhet në letërën e ETUCE-s drejtuar presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, Avokatit të Popullit, Hilmi Jashari dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Jahjaga e Tërnavës në mesin e 500 personaliteteve më me ndikim në botën islame

EPOKA E RE Q. RAMA

PRISHTINË, 9 JANAR - Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga dhe myftiu Naim Tërnavë janë renditur në mesin e 500 personaliteteve më me ndikim në botën islame nga Qendra Mbretërore për Studime Islame dhe Strategjike (The Royal Islamic Strategic Studies Centre) me seli në Jordani.

Në edicionin e vitit 2020 myftiu Tërnavë radhitet në listën e liderëve me ndikimin administrativ më të madh, derisa Jahjaga në mesin e personaliteteve më me ndikim nga fusha e politikës. "Jahjaga ishte presidentja e parë dhe më e re e Kosovës nga viti 2011 deri në vitin 2016. Pasi diplomoi në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës në vitin 2000, ajo vazhdoi studimet

në Mbretërinë e Bashkuar dhe ShBA. Ajo më pas shërbeu në poste të ndryshme qeveritare, duke përfshirë gradën e gjeneralemajore për Policinë e Kosovës", ka shkruar Qendra Mbretërore për Studime Islame dhe Strategjike.

Ndërsa myftiu Tërnavë përmendet si figura kryesore në përpjekjet e popullatës myslimane të Kosovës për t'i kapërcyer tmerret e luftës. "Naim Tërnavë është kryeimami i Kosovës. Ai është figura kryesore fetare në Kosovë, i cili u shfaq pas një lufte etno-fetare që rezultoi në humbje të madhe të jetëve dhe shkatërrimit. Tërnavë është një figurë kryesore në përpjekjet e popullatës myslimane të vendit për t'i kapërcyer tmerret e luftës. Ai pati rol të rëndësishëm në krijimin e Organizatës së



Këshillit Ndërfetar për Marrëdhëniet Ndërfetare", e ka përshkruar Tërnavën Qendra Mbretërore për Studime Islame dhe Strategjike.

Në Bashkësinë Islame të Kosovës kanë deklaruar se përzgjedhja e Tërnavës në këtë listë dëshmon angazhimin e tij institucional për t'i çuar përpara

institucionet fetare islame në vend dhe për të krijuar raporte me institucionet e tjera fetare e shtetërore në Republikën e Kosovës. "Tash e sa vite Qendra Mbretërore për Studime Islame dhe Strategjike (The Royal Islamic Strategic Studies Centre) me seli në Jordani, myftiun e Republikës së Kosovës, Naim ef.

Tërnavë, e radhit në mesin e personaliteteve më me ndikim në botën islame. Në edicionin e vitit 2020 myftiu Tërnavë radhitet në listën e liderëve me ndikimin administrativ më të madh, gjë kjo që dëshmon për angazhimin e tij institucional për t'i çuar përpara institucionet fetare islame në vend dhe për të krijuar raporte me institucionet e tjera fetare e shtetërore në Republikën e Kosovës. Kjo përzgjedhje është një motiv shtesë jo vetëm për myftiun Tërnavë personalisht, por për të gjithë vartësit dhe nëpunësit e BIRK-ut për ta vazhduar kontributin për të mirën e shoqërisë, sikur që është një dëshmi shtesë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për punën që bën Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës", ka njoftuar BIK-u.

Komuna e Mitrovicës së Jugut përmbyll vitin 2019 pa asnjë vrasje

MITROVICË, 9 JANAR (ER) - Drejtorja Rajonale e Policisë në Mitrovicë ka prezantuar të enjten raportin e punës për vitin 2019, me ç'rast, bazuar në vlerësimet analitike të bëra në raportet periodike, viti 2019 shënon rënie të përgjithshme të incidenteve dhe rasteve të tjera penale. Me këtë rast morën pjesë kryetari i komunës, Agim Bahtiri, kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, drejtoresha Rajonale e Policisë, nënkolonel Afërdita Mikullovc, komandanti i Stacionit Policor në Jug, Ahmet Xhosha, si dhe zyrtarë të tjerë të lartë të Policisë.

Fillimisht fjalën e mori drejtoresha Rajonale e Policisë në Mitrovicë,



nënkolonel Afërdita Mikullovc, e cila ka falënderuar kryetarin Bahtiri për bashkëpunimin e mirëfilltë që kanë pasur gjatë tërë kësaj kohe, duke theksuar më pas se në rezultatet e arritura që janë inkurajuese, policia e Stacionit

Jugor i ka kryer me përpikëri të gjitha detyrat e parapara me planin e punës. Ajo ka shtuar se rënia e numrit të rasteve në përgjithësi rezultoi me efikasitetin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisë e sektorëve të ndryshëm.

Ky rezultat reflekton angazhimet e vazhdueshme policore dhe masat e ndërmarra në parandalimin e veprave penale.

Ndërsa kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka përgëzuar të gjithë policët për efikasitetin dhe punën e tyre të shkëlqyeshme për zbatimin e ligjit, krijimin e një ambienti të sigurt për qytetarë, ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike.

Po ashtu, kryetari Bahtiri ka potencuar se kanë bashkëpunim mjaft të mirë dhe të vazhdueshëm me policinë për parandalimin e tensioneve apo incidenteve të ndryshme dhe si rezultat i këtij bashkëpunimi, i qytetarëve, pushtetit lokal, policisë, janë shënuar këto rezultate jashtëza-

konisht të mira. "Këtë e dëshmon fakti që ky vit që lamë pas u përmbyll pa asnjë vrasje në Mitrovicë", ka thënë ai.

Drejtorja Rajonale në Mitrovicë ka falënderuar të gjithë qytetarët e Mitrovicës për një bashkëpunim të ndërsjellë dhe ndërgjegjës, gjë që ka reflektuar që gjatë vitit 2019 për të mos pasur asnjë vrasje.

Drejtorja Rajonale në Mitrovicë ka ndarë mirënjohje falënderuese për kryetarin Bahtiri, për bashkëpunimin e mirëfilltë dhe punën e shkëlqyer, po ashtu mirënjohje ka u ndarë edhe bashkëpunëtorëve të tjerë dhe disa zyrtarëve të lartë të këtij Stacioni Policor.

Haradinaj: Kosovës ende i duhet mbështetja e Gjermanisë për anëtarësim në mekanizma ndërkombëtarë



"Kosova ka arritur të krijojë aleatë të fuqishëm dhe përkrahja e Gjermanisë është tejet e nevojshme për ta vazhduar integrimin e vendit në familjen e madhe evropiane dhe për mundësimin e lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës, kushtet për të cilin fakt, vendi tashmë i ka plotësuar", ka thënë kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, gjatë takimit me drejtoreshën për Evropën Juglindore, Turqi dhe shtetet anëtare të Asociacionit Evropian për Tregti të Lirë në Ministrinë e Jashtme Gjermane, Susanne Schutz

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 JANAR - "Kosova dhe Gjermania suksesshëm kanë thelluar bashkëpunimin bilateral në fushën politike dhe ekonomike si një e arritur e madhe strategjike për vendin dhe rajonin", kështu ka thënë kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në takim me Susanne Schutz, drejtoreshë për Evropën Juglindore, Turqi dhe shtetet

anëtare të Asociacionit Evropian për Tregti të Lirë në Ministrinë e Jashtme Gjermane, me të cilën ka biseduar për zhvillimet e përgjithshme në vend dhe rajon si dhe për bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë. Fillimisht, kryeministri në detyrë, Haradinaj, e ka falënderuar Schutzin për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Kosovës në të gjitha periudhat, duke thënë se Kosova është falënderuese për një shtet mik siç është Gjermania. Me këtë rast, kryemi-

nistri në detyrë, Haradinaj, e ka njoftuar Schutzin, për proceset nëpër të cilat është duke kaluar Republika e Kosovës, me theks suksesin e Kosovës në procesin e fundit zgjedhor në vend dhe pritjet për konstituimin sa më të shpejtë të qeverisë së re dhe marrjen e përgjegjësi për proceset e rëndësishme që e presin vendin. "Kosova ka arritur të krijojë aleatë të fuqishëm dhe përkrahja e Gjermanisë është tejet e nevojshme për ta vazhduar integrimin e vendit në famil-

jen e madhe evropiane dhe për mundësimin e lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës, kushte për të cilin fakt, vendi tashmë i ka plotësuar", ka thënë Haradinaj. Më tej, Haradinaj ka thënë se Kosovës ende i duhet mbështetja e Gjermanisë për zhvillimin ekonomik, anëtarësimin në mekanizma ndërkombëtarë dhe rrugën e saj euroatlantike. "Parku Inovativ Trajnues Kosovaro-Gjerman në Prizren është një prej shembujve të mirë se si mund të rritet bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve tona, andaj Kosova është e gatshme dhe mirëpret investimet gjermane", tha kryeministri në detyrë Haradinaj dhe vlerësoi se Kosova është e fokusuar për avancimin e partneritetit me shtetin gjerman, siç është punuar shumë në jetësimin e projekteve ekonomike si ITP në Prizren dhe

Soëi Kosova dhe ngjashëm edhe në aspektin politik, duke e falënderuar Gjermaninë për qëndrimin konsistent në mbrojtjen e integritetit territorial të vendit. Po ashtu, kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka shprehur gatishmërinë e institucioneve të vendit për vazhdimin e dialogut, të kornizuar që çon në marrëveshje finale me njohje reciproke në kufijtë ekzistues dhe në partneritet të mirë me të gjitha vendet e rajonit.

Ndërsa Susanne Schutz, drejtoreshë për Evropën Juglindore, Turqi dhe shtetet anëtare të Asociacionit Evropian për Tregti të Lirë në Ministrinë e Jashtme Gjermane, ka falënderuar kryeministrin në detyrë Haradinaj për pritjen dhe shprehur gatishmërinë e shtetit gjerman për mbështetjen e Kosovës në të ardhmen.

Digjet makina e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës, Sllavko Simiq

MITROVICË, 9 JANAR - Makina e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës, Sllavko Simiq, i cili vjen nga radhët e Listës Serbe, është djegur të mërkurën.

Zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Branislav Radoviq, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se makina private është djegur para ndërtesës ku pronari S. S. banon.

Dëmi u vlerësua të jetë rreth 6 000 euro.

Prokurori përgjegjës e cilësoi rastin si "shkaktim të rrezikut të përgjithshëm".

Simiq së voni është emëruar



edhe kryetar i të ashtuquajturit "qark administrativ i Mitrovicës së Kosovës", institucion paralel

që funksionon në sistemin e Serbisë.

Në deklaratën e drejtorit të

përgjithshëm të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, thuhet se djegia e makinës së Simiqit është një "akt qyqar i atyre që besojnë se në këtë mënyrë mund ta heshtin vullnetin e popullit serb në Kosovë".

Gjuriq tha se u bënë thirrje autoriteteve përgjegjëse që, pa vonesë, t'i hetojnë dhe të mbajnë përgjegjës autorët e këtij sulmi.

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka dënuar aktin e djegies së veturës së nënkryetarit të Kuvendit,

Sllavko Simiq, në Leposaviq. Kryeparlamentari Konjufca ka vlerësuar se aktet e tilla kriminale, duke rrezikuar jetën e zyrtarëve të lartë shtetërorë dhe duke shkatërruar pasurinë e qytetarëve të Kosovës, përbëjnë shkelje të rëndë të rendit e të ligjit dhe si të tilla janë të dënueshme. "Inkurajoj organet e rendit dhe të drejtësisë që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për ta zbardhur sa më shpejt rastin dhe për t'i vënë para përgjegjësisë ligjore autorët e tij", është thënë në reagimin e Konjufcës.

Banka Botërore: Rritja ekonomike e Kosovës pritet të jetë 4.2 për qind

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 9 JANAR - Banka Botërore (BB) në raportin për prospektet ekonomike ka theksuar se ekonomia botërore do të rritet 2.5 për qind këtë vit, vetëm pak më shumë se parashikimi prej 2.4 përqindësh për vitin 2019. Sipas BB-së, rritja ekonomike e Kosovës për sivjet pritet të jetë 4.2 për qind. "Në Ballkanin Perëndimor pati një ngadalësim në investimet publike në Kosovë, të prodhimit në Serbi, dhe rritje e eksportit në Shqipëri dhe Serbia që kontribuoi në një moderim në rritje përafërsisht 3.2 për qind në vitin 2019. Në Kosovë rritja për këtë vit pritet të jetë 4.2 për qind", thuhet në raportin e Bankës Botërore.

Banka Botërore në raportin për prospektet ekonomike thotë se ekonomia botërore do të rritet 2.5 për qind këtë vit, vetëm pak më shumë se parashikimi prej 2.4 përqindësh për vitin 2019. Sipas institucionit huadhënies,

rritja ekonomike e Kosovës për sivjet pritet të jetë 4.2 për qind. "Në Ballkanin Perëndimor pati një ngadalësim në investimet publike në Kosovë, të prodhimit në Serbi, dhe rritje e eksportit në Shqipëri dhe Serbia që kontribuoi në një moderim në rritje përafërsisht 3.2 për qind në vitin 2019. Në Kosovë rritja për këtë vit pritet të jetë 4.2 për qind", thuhet në raport.

Ekonomisti në Bankën Botërore, Ayhan Kose, ka thënë se kjo rritje modeste në ekonominë botërore shënon fundin e ngadalësimit që filloi në vitin 2018. "Ne presim përmirësime por, në përgjithësi, shohim edhe perspektiva më të dobëta të rritjes", ka deklaruar Ayhan Kose.

Ndërkaq guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, gjatë prezantimit të të arriturave për vitin 2019 kishte thënë se rritja ekonomike për vitin 2020 do të jetë 4.2 për qind.

"Rritja ekonomike në vend vlerësohet të jetë 4.2 për qind, e mbështetur kryesisht nga investimet dhe eksportet neto. Sipas



vlerësimeve edhe për vitin e ardhshëm rritja do të jetë e njëjtë. Nga të dhënat e inflacionit që i kemi deri në fund të

muajit nëntor, shënon 2.8 për qind që është dukshëm më i lartë që ka qenë një vit më herët, realisht ka shënuar rritje 0.9 për

qind. Kjo rritje e inflacionit është si rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit", kishte thënë Mehmeti.

2019-a, viti më i suksesshëm deri tash për Aeroportin e Prishtinës



Prishtinë, 9 janar (ER) - Viti 2019 ka qenë më i suksesshmi deri tash për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Më 2019 ky aeroport pati rritje prej 9.4

përqindësh në krahasim me një vit më herët, kështu duke shënuar vitin me më së shumti pasagjerë. Gjatë vitit 2019 ky aeroport shërbeu për gati 2.4 milionë pasagjerë, sipas të dhënave

të Aeroportit të Prishtinës. "Aeroporti i Prishtinës, më 2019, pati saktësisht 236 976 7 pasagjerë. Kjo ishte rritje prej rreth 204 mijë udhëtarëve në krahasim me vitin 2019. Muaji më i ngarkuar

ishte muaji gusht me 302 mijë udhëtarë, ndërsa më me së paku ngarkesë ishte muaji shkurt me 138 mijë udhëtarë. Secili muaj shënoi rritje në krahasim me muajt e njëjtë të vitit paraprak,

me janarin e qershorin që për dallim nga viti 2018 shënuan rritje prej 17.1 përqindësh, duke paraqitur rritjen më të madhe në përqindje", thuhet në njoftimin e Aeroportit të Prishtinës.

Eksporti shënoi rritje për 9 për qind

Sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), për vlerësimin e tremujorit të tretë (TM3) të vitit 2019, eksporti i mallrave deri në shtator 2019 ka shënuar vlerën prej 288.8 milionë eurosh, që është për 9 për qind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 JANAR - Sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), për vlerësimin e tremujorit të tretë (TM3) të vitit 2019, deficitin në llogarinë e mallrave arriti vlerën prej 1.26 miliard eurosh deri në shtator 2019, që paraqet një rritje vjetore prej 3.3 përqindësh. "Deri në gusht 2019 deficitin i llogarisë rrjedhëse ishte 67 milionë euro që është për 60.7 për qind më ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Zvogëlimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore, ndërsa deficitin i mallrave ka shënuar rritje të ngadalësuar", është thënë në raportin e BQK-së për vlerësimin në tremujorin e tretë të vitit 2019. Sipas këtij raporti, deficitin në llogarinë e mallrave arriti vlerën prej 1.26 miliard eurosh deri në shtator 2019, që paraqet një rritje vjetore prej 3.3 përqindësh. "Përderisa në vitin 2018 ishte shënuar rënie e eksportit të mallrave dhe përshpejtim i rritjes së importit, në vitin 2019 është duke u shënuar rritje e eksportit të mallrave dhe rritje më e ngadalësuar e importit. Kjo ka ndikuar që

shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte të ketë një përmirësim nga 10.8 për qind sa ishte në shtator 2018 në 11.3 për qind në shtator 2019. Eksporti i mallrave deri në shtator 2019 ka shënuar vlerën prej 288.8 milionë eurosh, që është për 9 për qind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018", është thënë në raport.

Sipas këtij raporti, rritja e eksportit të mallrave ishte më e theksuar te metalet bazë, produktet e plastikës dhe gomës si dhe makineritë dhe pajisjet elektrike. "Në anën tjetër, rënie shënoi eksporti i produkteve minerale, eksporti i lëkurës dhe artikujve të lëkurës, eksporti i perimeve, etj", thuhet në raport.

Referuar BQK-së, vlera e importit të mallrave deri në shtator 2019 ishte 2.5 miliardë euro, që është për 3.6 për qind më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. "Rritje më e lartë u shënuar tek importi i mjeteve të transportit, produkteve minerale, tekstilit dhe artikujve të tekstilit si dhe produktet e plastikës dhe gomës etj. Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 803.3 milionë eurosh deri në gusht 2019, një rritje prej 11.2 përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Vlera

e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 8.5 përqindësh, duke arritur në 1.3 miliard euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoi rritje prej 4.3 përqindësh dhe arriti në 499.1 milionë euro. Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore, deri në gusht 2019,

shënoi vlerën prej 115.5 milionë eurosh, që paraqet një rritje prej 73 përqindësh", është thënë në raportin e BQK-së, duke u shtuar se bilanci i të ardhurave dytësore ka shënuar rritje për 2.2 për qind, që i atribuohet kryesisht nivelit më të lartë të remitencave.

Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore shënuan vlerën prej 553.3 milionë eurosh deri në gusht 2019, apo 6.3 për qind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018.

Zvicra dhe Gjermania prijnë për remitanca

Sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për vlerësimin e tremujorit të tretë (TM3) të vitit 2019, remitencat që pranohen në Kosovë kryesisht vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, prej nga dërgohen 41.3 përqindësh 19.8 për qind e gjithsej remitencave. "Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga ShBA-ja, gjegjësisht 7.1 për qind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Në kuadër të llogarisë financiare, hyrjet e IHD-ve në Kosovë

arritën vlerën prej 199.2 milionë eurosh duke shënuar rritje prej 22.9 përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 161 milionë eurosh dhe shënoi rritje prej 2.1 përqindësh, ndërsa IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 38.2 milionë eurosh (4.4 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2018)", është thënë në raport.

ATK-ja vazhdon ta ketë përkrahjen nga misioni i FMN-ja



PRISHTINË, 9 JANAR (ER) - Misioni aktual, i cili po qëndron në ATK nga e enjtja deri më 21 janar 2020, ka në fokus vlerësimin e zbatimit të Planit Afatmesëm të Reformës 2019-2021, konkretisht

objektivat e parapara në këtë plan, siç janë trajtimi i borxheve tatimore, avancimi i funksionit të kontrollit tatimor, rimbursimi i TVSh-së si dhe avancimi i teknologjisë informative.

Administrata Tatimore e Kosovës vazhdon ta ketë përkrahjen nga misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar për zhvillimin e proceseve të rëndësishme të punës, përkrahje kjo që do të

vazhdojë edhe në të ardhmen. Përgjatë kësaj periudhe misioni në fjalë do të mbajë takime specifike dhe punëtori me qëllim të diskutimit të aktiviteteve të mundshme të cilat do ta ngritin

efikasitetin e administratës tatimore. Gjithashtu, do të diskutohet edhe për fushat konkrete për të cilat ATK-ja do të pranojë përkrahje në zhvillimin e kapaciteteve.

Lladrovci takohet me ambasadorin e Kosovës në Katar

DRENAS, 9 JANAR (ER) - Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, është takuar me ambasadorin Amir Ahmeti dhe stafin e tij dr. Rexhep Ismajli dhe Eshref Haxhiu në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Katar, Doha. Lladrovci në këtë takim ka theksuar rëndësinë

dhe nevojën që kanë investimet nga vendet mike në Drenas. "Drenasi ofron kushte dhe mundësi të mira për investime, andaj mirëpresim çdo interesim për investime që do të ndikonin për krijimin e vendeve të punës në komunën tonë. E përgëzoja

ambasadorin Ahmeti për mikpritjen, për aktivitetet e tij për promovimin e vendit, vlerave dhe potencialit tonë për investitorët. Faleminderit ambasador, jeni të mirëseardhur në komunën tonë!", ka shkruar Lladrovci në llogarinë e vet në "Facebook".



Çifti nga Zvicra e bën me banesë një familje gjiljanase

GJILAN, 9 JANAR (ER) - Çifti nga Zvicra, Esha Ismaili dhe Samir Kica, e kanë bërë me banesë të re një familje gjiljanase, e cila deri më tani ka jetuar në kushte të rënda banimi. Me këtë rast, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, i ka pritur në takim falënderues ata, duke thënë se nuk ka vepër më humane se ta bësh me shtëpi një familje në nevojë. Kryetari Haziri ka njoftuar çiftin nga Zvicra se kjo është familja e 132-të që po bëhet me kulm mbi kokë në Gjilan, pas mbremjes së parë humanitare të vitit 2014, duke shtuar se e bën krenar solidariteti i jashtëzakonshëm qytetar me

këto familje. Ndërsa çifti Esha Ismaili, e cila është gjiljanase dhe Samir Kica, i cili është nga Struga, kanë thënë se ndihen mirë që kanë arritur ta përbushin një synim të tyre për ta bërë me kulm mbi kokë një familje. Ata janë zotuar para Hazirit se do të vazhdojnë t'i dalin në ndihmë edhe në shkollimin e tre fëmijëve të kësaj familje. Përpos ndërtimit të shtëpive e blerjes së banesave për familjet me problem të banimit, në Gjilan janë rinovuar mbi 50 shtëpi, ndërsa për 51 familje Komuna e Gjilanit po paguan qira mujore, tash e katër vjet.



Në Gjakovë mbahet debati publik për planin e integritetit



Gjakovë, 9 janar (ER) - Komuna e Gjakovës ka organizuar të enjten një debat publik për planin e integritetit. Sipas kësaj komune, plani i integritetit është dokument i brendshëm i Komunës së Gjakovës, i cili pritet të vihet në funksion menjëherë pas miratimit të tij në mbledhjen e ardhme të Kuvendit Komunal. "Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit, në rastin konkret të

Komunës së Gjakovës dhe është një proces i dokumentuar për ta vlerësuar nivelin e cenueshmërisë së komunës dhe ekspozimin e saj ndaj praktikave joetike dhe të korrupsionit. Efekti kryesor i këtij dokumenti është rritja e mëtejshme e besimit të palëve të brendshme dhe të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga komuna", ka njoftuar Komuna e Gjakovës.

Sot hapet për qarkullim të veturave rruga 'Skënderbeu' në Kamenicë

KAMENICË, 9 JANAR (ER) - Komuna e Kamenicës ka bërë me dije se sot (e premte) do të hapet rruga "Skënderbeu" për qarkullim të rregullt të veturave. "Komuna e Kamenicës, pas përfundimit të festave të fundvitit, ka larguar dritat, këndin e lojërave dhe

bredhin në sheshin 'Metush Krasniqi'. Nga data 10 janar 2020 (e premte) pritet të fillojë qarkullimi i rregullt i veturave në rrugën 'Skënderbeu'. Komuna falënderon të gjithë qytetarët për bashkëpunim", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.



Muharremaj pret në takim qytetarët e Suharekës

Suharekë, 9 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka pritur në zyrë qytetarë të cilët kanë shprehur interesimin për ta takuar të parin e kësaj komune. Kjo

komunë ka njoftuar se takimet me qytetarë mbahen çdo të enjte, ku kryetari Muharremaj takon të gjithë ata që janë të interesuar të takohen me të dhe para tij t'i shprehin kërkesat dhe shqetësimet.

Beteja e Peranit, betejë e krenarisë së luftës së UÇK-së



Shkruan: Ylber ÇITAKU

Në përvjetorin e 21-të!

Dita 9 janar 1999 ishte ditë e shtunë, një ditë e ftohtë e me borë.

Para 21 vjetëve, pikërisht në këtë ditë, forca të mëdha serbe ia kishin mësyre grykës së Llapit, të cilave po u printe gjenerali Bojoviq, i biri i Milanit, me prejardhje nga fshati Peran. E fshati Peran gjendet në pjesën veriore, 2.5 kilometra larg nga qyteti i Podujevës.

Në drejtim të grykës së Llapit, atë ditë xhipat ngjyrë portokalli të OSBE-së provuan t'i ndalin forcat serbe në hyrje të fshatit, ngaqë zyrtarët e OSBE-së vetëm pak ditë më parë i kishin vizituar pozicionet e togut "Ulpiana 34", të vendosura në fshatin Peran. Ata ishin në dijeni për vendosmërinë e ushtarëve të UÇK-së që forcat serbe nuk mund të kalojnë drejt grykës së Llapit, rrjedhimisht bënë edhe përpjekjen e fundit për t'i ndalur pa gjakderdhje.

Dy javë më herët, në Betejën e Tabet e Llapashticës forcat serbe kishin dështuar për të depërtuar deri te tek Shtabi i Zonës, andaj ata kishin ndarë

mendjen që me çdo çmim dhe me çdo kusht të depërtojnë në këtë pjesë të Llapit, prandaj me tanke zhvendosen xhipat ngjyrë portokalli të OSBE-së, të cilët ishin vendosur tërthorazi në rrugë me qëllim të ndalimit të forcave serbe, zhvendosjen e këtyre xhipave e bënë me arrogancë e agresivitet të paparë, veprim ky që kishte për qëllim t'i arrijë dy efekte: demonstrimin e forcës dhe frikësimit e ushtarëve të togut "Ulpiana 34", të cilët kishin disa javë që ishin vendosur në këtë fshat. Por, ky agresivitet i forcave serbe nuk e arriti efektin e synuar, përkundrazi pati efekt të kundërt, sepse morali tek ushtarët e UÇK-së veç sa u rrit edhe më shumë.

Beteja filloi pak minuta para orës 10, ndërkaq luftimet ishin të ashpra, e forcat serbe ishin të pajisura me tanke, me autobllinda dhe me mjete të tjera që llogariten si artileri e rëndë, kurse ne ushtarët e UÇK-së me çfarë kishim, e sa i përket armatimit e kishim një gulinov, dy pushkamitraloza, dy snajperë, dy mortaja dore, dy zola dhe një numër të konsiderueshëm pushkësh, por mbi të gjitha e kishim vendosmërinë. Duhet cekur se pozicionet tona ishin goxha të volitshme, transhetë-istikamet, edhe pse te balto-sura, ishin hapur nga banorët e fshatit Peran dhe fshatrat përreth, për ç'gjë fshatarët e meritojnë një falënderim të veçantë. Luftimet e pandërprera zgjaten deri në orën 15, e deri në këtë kohë ne i kishim dy të vrarë,

kurse forcat serbe, sipas shënimeve të Spitalit në Podujevë, i kishin 9 të vdekur dhe rreth 30 të plagosur (duhet cekur se një numër i ushtarëve e policëve serbë të vrarë e të plagosur janë bartur drejtpërdrejt në Prishtinë, kurse një numër i vogël në Kurshumli, prandaj për numrin e tyre nuk kemi informacion), kurse humbjet në teknikë ushtarake nga forcat serbe ishin një tank dhe dy autobllinda.

Rreth orës 15:00 komandanti i brigadës 152, duke e parë shpërputhjen në armatim dhe në numër të ushtarëve, por edhe duke e ditur se istikamet në pozicionet e dyta ishin shumë më të volitshme për mbrojtjen e jetës së ushtarëve, sepse ishin hapur me buldozer, nëpërmjet radiolidhjes dha urdhër që të tërhiqemi në pozicionet e dyta, e pasi në kohë luftime urdhri i eprorit nuk diskutohet, por vetëm zbatohet, ashtu edhe vepruam. Në pozicionet e dyta nga Shtabi i Zonës, ndër të tjerë, erdhi edhe komandant "Fati", në fakt ai e kishte ndihmuar togun nga një pozicion goxha i vështirë, kurse disa orë më parë ai ishte pozicionuar në një luginë në pjesën jugperëndimore të togut "Ulpiana 34".

Komandant "Fati", pasi e shpërndau nga një cigare për ushtarët me një maturi, m'u drejtua me pyetjen se përse ushtarët janë mrrolur, ndërsa përgjigja ime ishte e menjëherëshme se ushtarët nuk kanë qenë

të gatshëm t'i lëshojnë pozicionet e para me asnjë kusht, kurse pa u menduar dy herë komandant "Fati" na pyeti nëse e kemi vullnetin dhe gatishmërinë që të kthehemi në pozicionet e para. Unë i kërkova dy-tre minuta kohë derisa të konsultohem me shokët, e atëherë e kuptova se të gjithë ushtarët ishin të vendosur për këtë hap, përkatësisht për t'u kthyer në pozicionet e para.

Pasi u njoftua për synimin, komandanti i Brigadës e dha lejen për kthimin në pozicionet e para, duke e njohur terrenin, dhe nëpërmjet një strategjie, por edhe me vendosmëri, ne arritëm që para orës 17 t'i kthejmë pozicionet tona, pra pozicionet e para, edhe përkundër luftimeve pothuajse të përditshme dhe përpjekjeve të vazhdueshme të forcave serbe për të depërtuar në grykën e Llapit, gjë që ata nuk e arritën. Këto pozicione janë mbajtur deri më 27 mars 1999, kohë kjo kur forcat serbe depërtuan nga krahu verior duke përdorur me qindra tanke dhe mjete tjera motorike. Pa dashur ta glorifikoj qëndresën dhe luftën e ushtarëve të togut "Ulpiana 34" të Zonës Operative të Llapit, sepse secili rast, sikur edhe çdo betejë i ka specifikat e veta, shtrohet pyetja: Cila është specifika e Betejës së Peranit, e datës 9 janar 1999? Shumica absolute e betejave të UÇK-së shquhet për specifikat si shpërputhja në armatim, dallimet në moral e vullnet, numri joproportional i ushtarëve dhe specifikat tjera, prandaj edhe

Beteja e Peranit kishte këto dhe specifika tjera, por nuk di dhe nuk besoj që ka betejë të zhvilluar në luftën për lirinë e Kosovës që forcat serbe në një betejë të udhëhiqej nga dy vëllezër gjeneralë, siç ishte rasti i kësaj betejë, njëri nga vëllezërit Bojoviq, që me gradë ushtarake ishte gjeneral e u printe forcave serbe, kurse vëllai i tij, i cili po ashtu ishte me gradë ushtarake gjeneral dhe ishte këshilltar për siguri i kasapit të Ballkanit, S. Millosheviq. Jam i vetëdijshëm se një numër i njerëzve që do ta lexojnë këtë shkrim do të shtrojnë pyetje e dyshime se si është e mundur kjo, ndërsa unë jam vetëm njëri nga ushtarët e këtij togu që mund ta konfirmoj këtë: Dy gjeneralë dhe një batalion i tërë u ndalën nga një grusht ushtarësh me armatim modest, por të vendosur që ta mbrojnë vendin e tyre.

Historia e njerëzimit njeh shumë beteja kur forcat kundërshtarë nuk kanë qenë të barabarta në armatim dhe në përgatitje, por fitimtarë kanë dalë ata të cilët e kanë pasur vullnetin, guximin, vendosmërinë dhe të drejtën e tyre në luftë për liri.

Lavdi dëshmorëve të kësaj betejë Nazmi Ismaili dhe Ismet Beqiri! Përrjetë mirënjohës dhe falënderues ushtarëve të togut "Ulpiana 34" të Zonës Operative të Llapit, si dhe fshatarëve të Peranit, të cilët e rrezikuan jetën dhe familjet e tyre në mbështetje të luftës për liri në mbështetje ushtarëve të togut "Ulpiana 34".

Një muaj paraburgim pasi transportonte ilegalisht palestinezë

Prizren, 9 janar (ER) - Gjykata Themelore e Prizrenit ka caktuar një paraburgim ndaj të pandehurit me iniciale F. M. nga Fushë-Kosova për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale kontrabandim të migrantëve. Nga Gjykata thonë se masa e paraburgimit do të llogaritet prej datës së arrestimit, 07. 01. 2020 dhe do të zgjasë deri më 06. 02. 2020. "Ekzistojnë bazat ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni 187, par. 1, nënpar. 1.1. dhe 1.2 në lidhje me pikën 1.2.3 të KPPRK-së, duke marrë parasysh peshën e veprës penale, mënyrat dhe rrethanat në të cilën është

kryer vepra penale ku i pandehuri me iniciale F. M., në ditën kritike policia kufitare ka ndaluar automjetin "Tauran VW", të cilën ka qenë duke e drejtuar i pandehuri, ku pas kontrollimit është konstatuar se i njëjti ka transportuar migrant (palestinezë) të cilët ka pasur t'i transportojë sipas marrëveshjes paraprake prej pikës kufitare në Vermicë për në qendrën e azilit për të huaj në Magurë dhe për këtë nga secili ka pasur për të marrë nga 20 euro. Kurse a do të argumentohen këto fakte, do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale", thuhet në njoftimin e Gjykatës.



LAMTUMIRË XHEVAT



Ismet SYLEJMANI

I dashur dhe i nderuar Shoku im, Heroi i Kombit Xhevat Qerimi!

Sot je ardhur në varrezat e Dëshmorëve dhe Heronjëve të Kombit në Gjilan, Ti njëri prej djemëve më besnik e më të shquar!

Aty do të pushosh në dekada si njëri prej luftëtarëve më të madhenj të popullit shqiptar! Bashkëveprimtari e Shoku im Xhevat Qerimi, po i shtohet radhëve e rreshtit të të pavdekurve të perjetshëm, të shekujve e mijëvjeçarëve të Atdheut tonë e të njerëzimit! Shqiptari zemër zjarr, shqiptari sy shqiponjë, Heroi i Kosovës martire, ishte dhe do të jetë përgjithmonë gjerdan nderi e respekti në ballin dhe në gjoksin e lavdishem të Atdheut!

Xhevat Qerimi, Heroi i Pavarësisë së Kosovës, sot përfundimisht edhe fizikisht me eshtrat e Tij të shenjta e të shtrenjta, po bëhet i pranishëm e afër të pavdekshmëve të mëdhenj, afër idolit të Tij, çelikut të qëndresës, të pamposhturit e të pathyeshmit Heroit të Kombit Rexhep Malaj, afër emblemës së bashkimit të shqiptarëve, Heroit të Kombit Kadri Zeka e afër besnikut të famshëm, Heroit të Kombit Nuhi Berisha!

Xhevat Qerimi, po rivarroset e po mbulohet me dheun e Atdheut, sepse këtë dhe të Atdheut, Ai e ka dashur shumë, për Të ka qenë i gatshëm të shkrihet e të digjet në çdo çast, ka qenë i gatshëm të vdes e të burgoset nga kushdo e me kë do që ka cenuar interesin dhe tërësinë e vendit!

Xhevat Qerimi, është organizuar, ka vepruar ilegalisht dhe është përgaditur ushtarakisht për të drejtuar luftën e popullit shqiptar, për të komanduar me njësitë e armatosura çlirimtare për largimin definitiv të Serbisë pushtuese nga Kosova dhe viset e saja nën ish-Jugosllavi!

Në Kodrën e Dëshmorëve në Gjilan, në panteonin gjigant, madhështorë e të lavdishëm, do të jetë vendëprehja e përbotshme e Kryetarit të Këshillit të parë të Rrethit të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës pa adresë të Gjilanit, Vitisë e Kamenicës!

Heroi Xhevat Qerimi, Gjilanin e kishte kryeqytetin e Tij të parë të pozitave të mëdha e të larta udhëheqëse e drejtuese, më vonë vazhdoi në Prishtinë dhe në vitin 1991 përfundoi në Kryeqytetin shqiptar në Tiranë, ku bashkë me shokun e Tij të armëve Heroin e Kombit, komandantin e UÇK-së Zahir Pajazitin e shumë tjerë i kryen me sukses ushtrimet ushtarake, ku u përgaditën për të drejtuar me armë në duar luftën titanike e finale, për të hequr qafe zgjedhën pushtuese serbe njëherë e përgjithmonë e për të bërë realitet ëndrrat e mijëra, qindra dhe miliona shqiptarëve, brenda e jashtë Atdheut!

Nga rruga e Tij lavdimadhe dhe liridashëse Heroin Xhevat Qerimi, me 10 Janar 1993 e ndau vdekja, e cili padrejtësisht e morri nga jeta, nga fëmijët e bashkëshortja, nga prindërit, nga motrat dhe vëllezërit e nga familja e Tij, por edhe e ndali hapin e Tij të madh dhe tepër të vendosur për të ecur me çdo çmim në rrugën e liridashëse për çlirimin e popullit dhe Atdheut!

Nga 10 Janari i vitit 1993 e deri në 10 Janarin e vitit 2020, mbushen 27 vite që kur ka pushuar së rrahuri zemra e Xhevatit të çelikt, i cili model të veprimit të Tij ilegal, politik-patriotik e kishte titanikun e çelikut e qëndresës Heroin e Kombit Rexhep Malaj, afër të cilit tani e tutje me disa metra larg njeri tjetrit do ta ndajnë me varret e tyre të shenjta tokën e Atdheut!

I dashur shoku e bashkëveprimtari im, Heroi i Pavarësisë së Kosovës Xhevat Qerimi, sot do të fillosh jetë të re të pavdekësisë Tënde, do të jeshë përkrahë komandantëve që i ke admiruar me shpirt e zemër dhe ushtarëve e luftëtarëve të UÇK-së, sepse bashkë me Komandant Zahir Pajazitin sikur të kishe qenë i gjallë, do të ishe në frontet e para dhe pa



Xhevat Qerimi
(1965 - 1993)



as më të voglin dyshim se do të kishe zhvilluar luftën dhëmb për dhëmb me policët, ushtarët, paramilitarët e kriminelët serb!

Të drejtohem nga larg me fjalët e fundit, ashtu sikur edhe para 27 viteve kur u ndava i fundit nga shoket te varri Yt, në Pozheran!

Lamtumirë Heroi Ynë i madh! Lamtumirë udhëheqësi, luftëtar e komandanti i parë i gjenëratës së re, pas Kadri Zekës e Rexhep Malës, Nuhi Berishës e

Zija Shemsiut, Nazmi Hoxhës, Hydajet Hysenit, Bejtullah Tahirit e shumë të tjerëve!... Lamtumirë Xhevati ynë i dashur e i shtrenjtë!

Lamtumirë organizatori e demonstruesi i madh i Gjilanit, Prishtinës dhe i gjithë Kosovës! Lamtumirë Babi i Qendresës dhe i Jetmirës!

Kosova jonë e dashur dhe e shtrenjtë me luftën e UÇK-së, me gjakun e derdhur për liri dhe me ndihmën e pakursyer e të madhe të Nanës Shqipëri dhe të aletatit tonë të madh

SHBA, është e lirë dhe e pavarur!

Pusho i qetë, Atdheu ynë për të cilin thurrim projekte e plane për çlirim, bashkim e prosperitet është në rrugën e duhur, është në rrugën e ëndrave tona që do të realizohen nga shqiptarët e ardhshëm!

Lamtumirë Shoku im! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës së lirë e të pavarur!

Lavdi e përjetshme Ty dhe gjithë Dëshmorëve e Heronjëve të Kombit!

Prishtinë, 10 Janar 2020!

E jashtëzakonshme

Festivali i akullit, destinacion për adhuruesit e dëborës dhe dimrit

Nëse ju pëlqen dëborë dhe parapëlqeni destinacione të ftohta, atëherë Festivali Ndërkombëtar i Skulpturës së Akullit dhe Dëborës Harbin është vend perfekt për ju. I vendosur në provincën Heilongjiang në veri të Kinës, Harbin është festivali më i madh në botë i dëborës dhe i akullit dhe përmban shumë



aktivitete spektakolare. Ky festival është hapur më 5 janar dhe mbyllet më 25 shkurt. Veprat e këtij viti janë bërë nga afro 220 000 metra kub blloqe akulli të tërhequra nga lumi Songhua.

FOTO E DITES



Fëmijët e shkollës indiane shihen duke bërë joga gjatë përrurimit të një feste ndërkombëtare të çiftit në Ahmedabad. /AP/

E rrallë

Qeni më i famshëm në rrjetet sociale

Fotografia e këtij qeni, që i përket racës Molossian, është një ndër pamjet më të komentuar në rrjetet sociale. Fytyra e çuditshme ka tërhequr vëmendjen e ndjekësve. Qeni me origjinë nga Kina ka një defekt fizik, me kafkën që është më e gjerë sesa e gjatë. Molossian është një racë e butë dhe miqësore me njerëzit. Pavarësisht mbarësh-



timit selektiv dhe modifikimit të fizionomisë së tij, pamja e tij nuk ndryshon, edhe pse nga ana shëndetësore është e mirë.

BARSOLETA E DITËS



Nëna e pyet djalin: Çka ka ndodhur në vitin 1405?
Djali: Lindi Skënderbeu.
Nëna: Po në vitin 1409?
Djali: Skënderbeu i bëri 4 vjet.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.
Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Sjellja e guximshme do t'i inkurajojë

beqarët të fillojnë histori të reja, por në jetën në çift mund të ketë një përlëshje në ajër.



DEMI
Yjet do ta hapin rrugën për ju dhe

shumë do të korri rezultate të mira në aktivitetet tuaja të zakonshme.



BINJAKËT
E enjte interesante në lidhje me çështjet

praktike. Me aftësinë që ju karakterizon aq shumë, do të dini se si të lëvizni me inteligjencë për të përfunduar disa marrëveshje të mira.



GAFORRJA
Më në fund pak qetësi! Me kalimin e

Hënës në shenjën tuaj, në sekuencën drejt Uranit, vullneti forcohet duke siguruar një sukses të papritur.



LUANI
Do të përjetoni disa çaste hutimi në

afeksione: Keni menduar për një marrëdhënie më të thellë dhe më të qëndrueshme, por në fund do ta kuptoni se nuk është ide shumë e mirë.



VI RGJËR ESHA
Një qiell miqësor hap

rrugën për një seri ngjarjesh që ju do të kenë mundësi vetëm t'i pranoni.



PESHORJA
Ironia do të jetë arma më e mirë për t'i

përballuar situatat që mund të bëhen mjaft të rënda.



AKREPI
Ka propozime interesante që mund të

vijnë nga larg, ose përmes rrjetëve sociale. Në punë do të ketë mjaft rrethana për t'i bërë dikë t'ju vërejë dhe për t'ia theksuar.



SHIGJETARI
Në nivelin profesional, dita fillon mirë, projektet tuaja fillojnë

menjëherë në këmbën e djathtë. Yjet lehtësojnë rezultatet ekonomike të nismave të fundit për sa kohë që ato lindin në bazë solide dhe reale.



BRICJAPI
Dëboni, pra, mendimet e errëta dhe

vlerësoni më shumë ato që kenë! Do të ketë një dëshirë të madhe për t'i ndryshuar situatat në të cilat jetoni, veçanërisht në një nivel sentimental.



UJORI
Me një intuitë të veçantë, ju do t'i shmangni

kurthet dhe do të shfrytëzoni mundësi shumë të mira. Një mik i dashur do të jetë në gjendje t'ju japë këshillat e duhura për një investim që do t'ju bëjë të fitoni shumë.



PESHQIT
Transiti harmonik i Hënës në gaforre

do t'ju lejojë të ndërmerrni një projekt për të cilin kenë menduar për disa kohë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Gashi: Besa rikthehet në Superligë

Dugagjin Gashi për "Epokën e re" ka thënë se nuk është i kënaqur me rezultatet e arritura në sezonin vjeshtor nga Besa e Pejës, por beson se ky klub do të rikthehet në Superligë në edicionin e ardhshëm. "Besoj se Besa në Superligë do të inkuadrohet pa problem sepse kemi një ekip stabil, por në pranverë duhet t'u qasemi ndeshjeve me një seriozitet shumë më të madh", ka thënë Gashi

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 JANAR - Mesfushori Dugagjin Gashi është optimist se skuadra e Besës së Pejës do të rikthehet në Superligë. Futbollisti me përvojë të madhe ka thënë të enjten për "Epokën e re" se do të ishte mëkat i madh nëse klubi pejan nuk e arrin të sigurojë inkuadrimitin në IPKO Superligë në fund të këtij edicioni. "Besoj se Besa në Superligë do të inkuadrohet pa problem sepse kemi një ekip stabil, por në pranverë duhet t'u qasemi ndeshjeve me një seriozitet shumë më të madh. Konkurrente kryesore do ta kemi Lirinë, por pa përjashtuar edhe Arbërinë dhe Malishevën. Do të ishte mëkat i madh nëse nuk arrijmë të inkuadrohemi në Superligë sepse jemi një klub me traditë të madhe në futbollin e Kosovës. Sivjet mobilizimi i klubit është mjaft i madh dhe të gjithë po besojmë se do t'ia arrijmë qëllimit", ka thënë Gashi, i cili nuk është i

kënaqur me rezultatet e sezonit vjeshtor të arritura nga skuadra e Besës. "Me rezultatet e arritura në sezonin vjeshtor nuk jemi të kënaqur aq shumë. E dimë që kemi mundur të kemi rezultate më të mira për faktin se kemi një ekip me përvojë. Kemi çaluar në disa ndeshje ku nuk është dashur të çalojmë", ka shtuar ajo. Më pas mesfushori i shumë klubeve në Kosovë ka folur edhe për të ardhmen e tij. Ai ka zbuluar se planifikon të pensionohet pas dy vjetëve, kurse do t'i mbushë 34 vjet. "Nuk kam vendosur asgjë, por do të luaj të paktën edhe dy vjet të tjera, pra deri në moshën 34-vjeçare. Momentalisht po ndihem shumë mirë fizikisht, por nuk do ta teproj shumë dhe, mbase, në moshën 34-vjeçare mund të pensionohem", ka deklaruar Gashi. Anëtar i Besës së Pejës ka luajtur edhe për Vëllaznimin, Drenicën, Feronikelin, Dukagjinin dhe Istogun. Ai ka zbuluar se dy gjërat që i kanë mbetur merak për kohën sa ishte në formën më të mirë

janë: mospjesëmarrja e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe pagesat jo të larta për lojtarët nga ana e klubeve elitare. "Kam arritur shumë suksese në karrierën time futbollistike. Me Besën e Pejës e kam fituar tri herë titullin e kampiones dhe dy herë e kam fituar Kupën. Kam ndihmuar edhe klubet që të shpëtojnë nga rënia, por edhe të inkuadrohen në Superligë. Po ashtu, kam qenë edhe futbollist i Përfaqësueses, por më mbetet shumë merak se nuk ka qenë Kosova e pranuar në arenën ndërkombëtare. Edhe kushtet tash janë rregulluar dhe shumata që fitojnë futbollistët janë shumë të mëdha në krahasim me vitet e mëhershme kur ne futbollistët që jemi pjesë e Besës ishim në top-formë. Krenohem me karrierën e ndritshëm", ka përfunduar Gashi. Skuadra e Besës sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e parë me 28 pikë, ku nga gjashtëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara arriti nëntë fitore, katër barazime dhe tri humbje.

SHKURT

Kosova zhvillon stërvitjet e para në Katar

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka mbërritur në Katar. "Dardanët" të enjten kanë zhvilluar dy stërvitjet e para në Doha në kuadër të përgatitjeve për miqësoren kundër Suedisë, e cila do të zhvillohet më 12 janar në orën 17:45 (sipas orës lokale në Doha). Përzgjedhësi Bernard Challandes në këtë grumbullim ka ftuar 25 futbollistë, prej të cilëve 13 nga elita e futbollit në Kosovë.

Xhudo nis përgatitjet për Lojërat Olimpike 'Tokio 2020'

Përzgjedhësi i Kosovës në xhudo, Driton Kuka, konfirmon se kanë nisur përgatitjet për edicionin e ri. Ai ka publikuar foto të stërvitjeve në Kampin Olimpik, në Austri. "OTC Mittersil 2020... Distria Krasniqi në aksion në Kampin Olimpik në Austri! Ekipi ynë olimpik i nis përgatitjet në vitin e ngjarjes më të madhe sportive sivjet në Tokio", ka shkruar Kuka në profilin e vet në "Facebook". Kosova kërkon të marrë pjesë me disa xhudistë në Lojërat Olimpike "Tokio 2020".

Gjyqtarët e basketbollit mund ta bojkotojnë kampionatin

Kampionati i Kosovës në basketboll mund të ngeçë në zhvillim shkak i mundësisë që gjyqtarët të hyjnë në grevë. Ata nuk janë paguar për disa muaj të vitit të kaluar dhe kanë kërkuar nga Federata e Basketbollit e Kosovës që t'i shlyejë obligimet ndaj tyre. FBK-ja po mundohet të gjejë mundësi t'ua kryejë pagesat gjyqtarëve, të cilët janë të vendosur që të mos referojnë pa u shlyer i gjithë borxhi ndaj tyre. Madje kërkojnë edhe rritje të pagesave. Nëse borxhet ndaj gjyqtarëve nuk kryhen brenda këtij muaji atëherë situata mund të përkeqësohet seriozisht në basketbollin e Kosovës.

Valdo Zeqaj nga Flamurtari i Vlorës kalon te Flamurtari i Prishtinës

Flamurtari ka bërë goditjen e radhës në afatin kalimtar të janarit. Sipas medieve shqiptare, kuqezinjtë kanë transferuar mbrojtësin Valdo Zeqaj. 24-vjeçari në sezonin vjeshtor ishte pjesë e skuadrës së Flamurtarit të Vlorës, kurse në sezonin pranveror do të jetë pjesë e Flamurtarit të Prishtinës. Skuadra kuqezi nga kryeqyteti i Kosovës synim e ka mbetjen në Superligë.

'Kicker': Rashica, ndër sulmuesit më të mirë në Bundesliga

Çdo gjashtë muaj "Kicker" lanson renditjen e lojtarëve më të mirë në Bundesliga në kategori të ndryshme. Aty është shpallur edhe lista me sulmuesit më të mirë të gjysmës së parë të edicionit 2019/20. Në sy bie edhe prania e sulmuesit nga Kosova, Milot Rashica. Futbollisti i Werder Bremenit është renditur në vendin e katërt. Para tij janë Robert Lewandowski, Timo Werner dhe Marcus Thuram. Ndryshe, këtë edicion me Werder Bremenin ka qenë më i miri. Në 15 ndeshje në të gjitha garat, vushtrriasi ka shënuar nëntë gola dhe ka dhuruar tri asistime.

Unitedi, 13 milionë paunda për Kumbullën

MANCHESTER, 9 JANAR - Manchester United është në një urgjencë në mbrojtje, teksa Harry Maguire do të qëndrojë jashtë fushave të blerta për një periudhë të gjatë për shkak të dëmtimit. Kjo ka bërë që "dajitë e kuq" të mos humbasin më kohë dhe të përfitojnë nga kjo

periudhë transferimesh për të mbyllur hapësirat në prapavijë. Kështu klubi anglez i ka hedhur sytë drejt Italisë, ku kërkon mbrojtësin shqiptar, Marash Kumbulla. Ky i fundit është vetëm 19-vjeçar dhe ka bërë një sezon të shkëlqyer në Serie A me Veronën, duke tërhequr

edhe interesin e shumë klubeve si Interi, Napoli, Juventus, Atalanta si dhe Manchester United. Anglezët e kanë shfaqur pëlqimin e tyre për futbollistin kuqezi këtë sezon, ndërsa tashmë vijon me një ofertë konkrete. Mediet angleze bëjnë me dije se një

ofertë prej 13 milionë paundësh do të shkojë në tryezën e Veronës. United kërkon menjëherë zëvendësuesin e Maguire dhe do të tentojnë që të sjellin Kumbullën që këtë muaj në Premier Ligë, megjithëse klubi italian dëshiron që ta mbajë mbrojtësin



shqiptar deri në fund të sezonit për ta lënë më pas të lirë.

Tare: Lazio synon kualifikimin në Ligën e Kampionëve

ROMË, 9 JANAR - Drejtori sportiv i Lazios, Igli Tare, ka thënë se klubi i tij duhet të rrijë i qetë e të fokusohet në "kualifikimin për në Ligën e Kampionëve". Lazio është aktualisht i treti në Serinë A, gjashtë pikë më pak se top-dyshja, por Tare ka refuzuar të flasë për garën për titull. "Jemi vetëm në gjysmë të sezonit. Kemi fituar shumë beteja, por do të duhet ta fitojmë luftën. Diskutimet për 'Scudetto' nuk na shqetësojnë ne. Qëllimi ynë ka qenë gjithmonë që të kualifikohemi për Ligën e Kampionëve", ka deklaruar Tare për "Corriere dello Sport". Lazio ka fituar nëntë ndeshje rresht dhe është në seri fantastike pa humbje në 12 ndeshjet e fundit në ligë. "Ëndrra është e bukur, por unë jam profesionist dhe dua të ec me këmbë në tokë. Duhet të mbesim me mend në kokë, të fokusuar e të



vetëdijshëm që të jemi ekip i madh. Më pas, nëse jemi në luftë për diçka tjetër gjatë ditëve të fundit të sezonit, nuk do të ndalemi", ka shtuar ai.

Lazio të shtunën përballlet me Napolin dhe një fitore për këtë klub do të ishte tregues i mirë për formën, ka shtuar 46-vjeçari.

Hardeni shkëlqen në fitoren e Houstonit

ATLANTA, 9 JANAR - Skuadra e Houstonit e mposhti me rezultat 122-115 Atlantën. James Harden realizoi 41 pikë, 10 rebounde e 10 asistime, në një ndeshje të dominuar nga ekipi teksan, duke i bërë të pavlefshme 42 pikët e Youngut për Atlanta. Fitore në sekondat e fundit për Denverin, që mposhti me rezultat 107-106 Dallasin, ndeshje me rivalitet dhe emocione. Donqiq realizoi 27 pikë e 10 asistime për Dallasin, por që mbetën për statistikë, ndërsa për Denverin u dallua Jokiç, autor i 33 pikëve. Rikthehet te fitorja ekipi i Milwaukee, që mundi me rezultat 107-98 nënkampionët e Golden State. Tjetër ndeshje e mirë e Antetokounmpos, që



realizoi 30 pikë e 13 rebounde. Fiton edhe ekipi i San Antonios, që mundi 129-114 Boston, sfidë e dominuar nga Spursi, ku u dallua DeRozani me 30 pikë. Miami mposhti 122-108 Indianan, takim ku diferencën në fushë për ekipin nga Florida e bëri Herro me 19 pikë. Pas kohës shtesë fiton skuadra kampione e Torontos, që e mposhti me rezultat 112-110 Charlotte, sfidë

ku herë udhëhiqte njëri ekipi e herë tjetri. Ibaka e Davis realizuan secili nga 23 pikë e 11 rebounde për kanadezët. Fitore të lehtë korri skuadra e New Orleansit, që e mposhti me rezultat 123-108 Chicagon, takim ku shkëlqeu Ingrami me 29 pikë e 11 asistime, ndërsa Utah Jazzi fitoi me rezultat 128-104 ndaj New York (Bogdanoviç 20 pikë).

REZULTATET

Boston - San Antonio	114-129
Charlotte - Toronto	110-112
Indiana - Miami	108-122
Atlanta - Houston	115-122
Dallas - Denver	106-107
New Orleans - Chicago	123-108
Utah Jazz - New York	128-104
Golden State - Milwaukee	98-107

SHKURT

Iniesta: Rikthimi i Neymarit do të ishte i mirë për Barçën

Andres Iniesta ka mbështetur mundësinë e rikthimit të Neymarit te Barcelona.

Ylli i Paris Saint-Germainit spekulohet për një rikthim në "Camp Nou". Iniesta beson se ardhja e Neymarit do të ishte e dobishme për ekipin e trajnerit Ernesto Valverde. "Bëhet fjalë për një prej futbollistëve më të mirë në botë në rolin e tij. Do të ishte një përforcim i madh për Barcelonën. Një tjetër gjë është nëse do të realizohet ose jo", ka thënë Iniesta për "Mundo Deportivo". Iniesta, po ashtu, bëri lëvdata për Leo Messin i cili së fundmi fitoi për herë të gjashtë "Topin e Artë". "Ai vazhdon të thyejë rekorde. Është lajmi më i mirë për Barcelonën që vazhdon të luajë në nivele të larta", ka shtuar Iniesta.

Di Montezemolo: Nëse pilotët garojnë për veten e tyre, Ferrari nuk mund të fitojë

Ish-presidenti i Ferrarit, Luca Di Montezemolo, ka folur për mënyrën se si Ferrari po menaxhon pilotët e saj nën drejtimin e Mattia Binotto. Ai i ka dhënë një këshillë këtij të fundit, në mënyrë që makina italiane të rikthehet në nivelet e dikurshme. "Veteli duhet të jetë i qetë dhe të ketë besim në forcat e veta", ka thënë Montezemolo. Ai ka këshilluar Binotto që t'ua bëjë të ditur pilotëve që, mbi të gjitha, rëndësi ka Ferrari dhe jo lavdia personale për t'i evituar polemikat që lindën gjatë vitit 2019. "Leclerc është një pilot i fortë, por edhe inteligjent, që mund të bëhet kampion", u shpreh Montezemolo. "Natyrishë që gjatë një sezoni ka edhe momente negative për një skuadër, por pilotët duhet të kuptojnë se nuk garojnë për veten e tyre, por për Ferrarin. Nëse Vettel dhe Leclerc nuk e kuptojnë këtë gjë, Ferrari nuk do të fitojë kurrë", ka deklaruar Montezemolo.

Unitedi mendon për Allegrin

Massimiliano Allegri që prej se është larguar nga Juventus është pa skuadër. Ai ka bërë me dije se do që të bëjë një vit pushime dhe të nisë një projekt fitues. "Daily Mail" raporton se emri i italianit është rikthyer si një opsion shumë i mundshëm për stolin e Manchester Unitedit. Ecuria e dobët e skuadrës legjendare angleze nën drejtimin e Solskjaer, bën që drejtuesit të kërkojnë për zëvendësuesin e tij. Një ofertë nga një klub si Manchester Unitedi vështirë se do të refuzohej dhe nuk është e pamundur ta shohim Allegrin t'i drejtojë "dajtë".

Milik kushton 70 milionë euro

Arkadiusz Milik është kthyer në një prej pikave të më forta të Napolit, në një sezon ku të kaltrit nuk po arrijnë t'i respektojnë pritshmëritë. Klubi italian dëshiron ta "blindojë" polakun. Në garë për kartonin e tij janë futur fuqishëm Atletico Madrid dhe Manchester United, me anglezët që në rast se lojtari nuk arrin pajtimin me Napolin do ta bëjë maksimumin për ta marrë që në janar. Për kartonin e Milik, klubi italian kërkon 70 milionë euro.

Dy klube angleze në garë për Piatekun

Pas rikthimit të suedezit Zlatan Ibrahimoviç, Krzysztof Piatek mund të largohet nga Milani. Klubi kuqezi, gjithashtu, ka marrë vendim që ta vendosë në merkato, sulmuesin polak, i cili ka zhgënjyer në pjesën e parë të këtij sezoni. Piatek është transferuar një vit më parë te Milani, nga Genoa, ka arritur të shënojë vetëm 4 gola, në gjysmën e parë të këtij kampionati. "Calciomercato" raporton se Tottenhami ka shtuar interesimin për sulmuesin e Milanit, pas lëndimit të Harry Kane. Anglezi pritet të jetë jashtë fushave për një kohë të gjatë. Tottenhami nuk është skuadra e vetme e cila është e interesuar për Piatekin, pasi raportohet që edhe Aston Villa ka bërë një ofertë prej 30 milionë eurosh për sulmuesin polak.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të Dënave të Fituar me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:**

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i punës:	Anketues/ intervistues, përfshirës dhe mbikëqyrës për anketat në ndërmarrje dhe në ekonomi familjare (turizëm dhe konsum të energjisë)
Numri i referencës:	ASK-DSE-001
Tarifa e shërbimit:	I negociuar
Raportoni te:	Njësia e statistikave ekonomike në ASK
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Gjashtë (6) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK- 60

Detyrat dhe përgjegjësitë e anketuesve:

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me udhëzimet metodologjike dhe organizative (të dhënat bazike të anketave) dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketat në ndërmarrje dhe ekonomi familjare (për turizëm dhe konsum të energjisë).

- Të bëjnë grumbullimin e të dhënave për anketat në ndërmarrje dhe ekonomi familjare (për turizëm dhe konsum të energjisë).

- Të bëjnë identifikimin e të gjitha bizneseve në bazë të mostrës duke bërë anketimin e të gjitha ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare..

- Të respektojnë udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që duhet t'i parashtrorin personit përgjegjës në njësi raportuese dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkuara në udhëzime;

- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;

- Intervista zhvillohet në gjuhën shqipe.

- Të bëjnë raportimin ditor tek mbikëqyrësi.

- T'i përfundojnë anketat brenda afatit.

- Të mbajnë **sekret zyrtar** të gjitha informatat e pranuar nga njësitë raportuese.

Përgatitja shkollorë/përvoja:

- Të kenë të kryer së paku shkollën e mesme.

- Të kenë përvojë në përdorimin e teknologjisë informative (laptopëve / tabletave)

- Përparësi kanë kandidatet të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit.

- Përparësi kanë personat që kanë ndjekur kurse të teknologjisë informative apo që kanë marrë pjesë së paku në një anketë.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunimi;

- Përvoja e mëparshme në anketat e ngjashme,

- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;

- Aftësi dhe njohuri në shfrytëzimin dhe përdorimin e Regjistrave;

- Aftësi kompjuterike, word, excel, internet etj;

- Të kenë aftësi të mira organizative dhe të jenë të gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë, përfshirë fundjavat.

Detyrat dhe përgjegjësitë e stafit për përfshirje:

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative (Të dhënat bazike të anketave) dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në praktikë bazuar në udhëzimet për anketat në ndërmarrje dhe ekonomi familjare (për turizëm dhe konsum të energjisë).

- Pranojnë materialet nga mbikëqyrësi;

- Bëjnë kontrollimin e pyetësorëve dhe përfshirjen apo futjen e të dhënave në kompjuter;

- Bëjnë raporte ditore dhe javore për njësinë e statistikave ekonomike.

Përgatitja shkollorë dhe përvoja:

- Të kenë të kryer shkollën e mesme;

- Të kenë përvojë në përdorimin e teknologjisë informative (laptopëve / tabletave);

- Përparësi kanë kandidatet të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit;

- Përparësi kanë personat që kanë ndjekur kurse të teknologjisë informative apo që kanë marrë pjesë së paku në një anketë me metodën CAPI.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunimi;

- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;

- Të kenë aftësi të mira organizative dhe sipas nevojës, të jenë të gatshëm të punojnë me orar fleksibil, përfshirë edhe fundjavat;

- Aftësi kompjuterike, Word, Excel, internet etj, janë të nevojshme.

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mbikëqyrës:

- Të marrin pjesë në trajnim dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe organizative (të dhënat bazike të anketës, (të dhënat bazike të anketës, të dhënat mbi qarkullimin e bizneseve) dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketat në ndërmarrje dhe ekonomi familjare (për turizëm dhe konsum të energjisë).

- Të mbikëqyrin mbarëvajtjen dhe realizimin e anketave në ndërmarrje dhe ekonomi familjare (për turizëm dhe konsum të energjisë), në terren.

- Në raste nevojë, të ju ndihmojnë anketuesve në teren në gjetjen e njësisë raportuese dhe krijimin e kontakteve me njësitë raportuese.

- Të bëjnë identifikimin e të gjitha problemeve dhe të bashkëpunojnë me anketuesit dhe zyrtarët e statistikave ekonomike në ASK.

- Të respektojnë udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që duhet t'i parashtrorin personit përgjegjës në njësi raportuese dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkuara në udhëzime;

- Përdorimi i adresave dhe listave për bizneset si dhe ekonomit familjare nga Mostra;

- Të njoftojnë zyrtarin për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;

- Të bëjnë raportimin në baza dyditore tek zyrtari.

- Të angazhohen që anketat të përfundojnë brenda afatit.

- Të mbajnë **sekret zyrtar** të gjitha informatat e pranuar nga njësitë raportuese.

Përgatitja shkollorë /përvoja: për mbikëqyrës të Anketave në Ndërmarrje:

- Të kenë të kryer ndonjë nga fakultetet (obligative),

- Kandidatët me përgatitje më të lartë shkollorë kanë përparësi;

- Përvojat e mëparshme në mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së anketave në terren, kanë përparësi;

- Përvoja në punë ekipore në rolin e mbikëqyrjes, kanë përparësi;

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;

- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;

- Aftësi dhe njohuri në shfrytëzimin dhe përdorimin e Regjistrave;

- Aftësi kompjuterike, Word, Excel, internet etj.

- Të kenë aftësi të mira organizative dhe të jenë të gatshëm të punojnë nganjëherë me orë pune më të gjatë, përfshirë fundjavat .

- Të jenë nga Regjioni ku kërkohet të zhvillohet Anketa e Ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare.

- Të kenë aftësi të mira komunikuese.

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web - faqen e ASK-së.

Numri i anketuesve	50 (pesë dhjetë)
Numri i mbikëqyrësve	6 (gjashtë)
Numri përfshirësve	4 (katër)

	Regjioni	Numri i anketuesve për regjion	Përfshirës	Mbikëqyrës
1	Gjakova	4	4	6
2	Gjilani	4		
3	Mitrovica	4		
4	Peja	5		
5	Prizreni	8		
6	Prishtina	20		
7	Ferizaj	5		
	Gjithsej	50	4	6

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/> .

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr." Zenel Salihu " nr. 4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: CV¹, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, tema e diplomës apo vërtetimi nga viti i fundit i nivelit të shkollimit (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testit me gojë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 apo 038-200 31 133 prej orës **08:00 - 16:00**.

¹ Përfshi: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

Naziv institucije:	Agencija za Statistiku Kosova
Naziv pozicije:	Anketar/ ispitivač, unosač i supervizor za ankete u preduzećima i domaćinstvima (za turizam i potrošnju energije)
Referentni broj:	ASK-OES-001
Tarifa usluga:	Po dogovoru
Izveštava:	Jedinica za ekonomsku statistiku u ASK
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge (SPU)
Trajanje ugovora:	Šest (6) meseci
Radno vreme:	Puno
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK- 60

Zadaci i odgovornosti anketara:

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima (osnovnim podacima anketa) i da bude spreman/na da ih primenjuje na terenu na osnovu uputstva za ankete u preduzećima i domaćinstvima (za turizam i potrošnju energije);
- Prikuplja podatke za ankete u preduzećima i domaćinstvima (za turizam i potrošnju energije);
- Vršiti identifikaciju svih poslovanja na osnovu uzorka anketiranjem svih preduzeća i domaćinstava;
- Poštuje uputstva upitnika za pitanja koja treba postavljati odgovornom ispitaniku i prati sve procedure i objašnjenja navedena u uputstvima;
- Obavesti supervizora o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Intervjuisanje se sprovodi na Albanskom jeziku;
- Dnevno izveštava svom supervizoru;
- Da završi Ankete u propisanom roku;
- Sve dobijene podatke od izveštajnih jedinica treba da čuva kao službenu tajnu.

Školska sprema /iskustvo

- Da ima najmanje završenu srednju školu;
- Da ima iskustvo u primeni informacione tehnologije (laptopa/tablet računara);
- Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja;
- Prednost imaju osobe koje su pohađale kurseve informacione tehnologije ili su učestvovali u barem jednoj anketi.

Kompetencije i veštine:

- Dobre veštine komuniciranja i saradnje;
- Prethodno iskustvo u sličnim anketama;
- Spreman/na za timski rad;
- Sposobnost i znanja u korišćenju i upotrebu Registara;
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd
- Da ima dobre organizacione veštine i spreman/na da ponekad radi prekovremeno, uključujući vikende.

Zadaci i odgovornosti unosača podataka:

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima (osnovnim podacima anketa) i da bude spreman/na da ih primenjuje na terenu na osnovu uputstva za ankete u preduzećima i domaćinstvima (za turizam i potrošnju energije);
- Primi materijal od supervizora;
- Proverava upitnike i unošenje ili unos podataka u računar;
- Izrađuje dnevne i nedeljne izveštaje za jedinicu ekonomskih statistika.

Školska sprema i iskustvo:

- Da ima završenu srednju školu;
- Da ima iskustvo u primeni informacione tehnologije (laptopa/tablet računara);
- Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja;
- Prednost imaju osobe koje su pohađale kurseve informacione tehnologije ili su učestvovali u barem jednoj anketi u kojoj je primenjena metoda CAPI.

Kompetencije i veštine:

- Dobre komunikacione veštine i saradnje;
- Spreman/na za timski rad;
- Da ima dobre organizacione veštine, i po potrebi, da bude spreman/na da radi prekovremeno, uključujući vikende.
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd je potrebno.

Zadaci i odgovornosti Supervizora:

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima (osnovnim podacima anketa, podacima o prometu poslovanja) i da bude spreman/na da ih primenjuje na terenu na osnovu uputstva za ankete u preduzećima i domaćinstvima (za turizam i potrošnju energije);
- Prati napredak i sprovođenje anketa u preduzećima i domaćinstvima (za turizam i potrošnju energije) na terenu;
- Po potrebi, pomaže anketarima na terenu u pronalaženju izveštajnih jedinica i uspostavljanje kontakta sa izveštajnim jedinicama.
- Identifikuje sve probleme i saraduje sa anketarima i službenicima za ekonomsku statistiku u ASK-u;
- Poštuje uputstva upitnika o pitanjima koje treba postavljati odgovornom ispitaniku u izveštajnoj jedinici i prati sve procedure i objašnjenja navedena u uputstvima;
- Koristi adrese i liste poslovanja i domaćinstava iz Uzorka;
- Obavesti službenika o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Izveštava službeniku na dvodnevnoj osnovi;
- Pobrini da ankete budu završene u propisanom roku;
- Sve dobijene podatke od izveštajnih jedinica čuva kao službenu tajnu.

Školska sprema/iskustvo supervizora za Ankete u Preduzećima:

- Da ima završen fakultet (obavezno);
- Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja;
- Prethodno iskustvo u praćenju napretka ankete na terenu, je prednost;
- Iskustvo u timskom radu u ulozi supervizora, je prednost;

Kompetencije i veštine:

- Dobre komunikacione veštine i saradnje;
- Spreman/na za timski rad;
- Sposobnost i znanja u korišćenju i upotrebu Registara;
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd;
- Da ima dobre organizacione veštine, i po potrebi, da bude spreman/na da radi prekovremeno, uključujući vikende;
- Da bude iz regiona gde treba da se sprovede Anketa preduzeća i domaćinstva;
- Dobre komunikacione veštine.

Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na veb- stranici ASK-a.

Broj anketara 50 (pedeset)
Broj supervizora 6 (šest)
Broj unosača 4 (četiri)

	Regioni	Broj anketara po regionu	Unosači	Supervizori
1	Đakovica	4	4	6
2	Gnjilane	4		
3	Mitrovica	4		
4	Peć	5		
5	Prizren	8		
6	Priština	20		
7	Uroševac	5		
	Ukupno	50	4	6

Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svi punoletni (stariji od 18.godina) Građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Podnošenje prijave:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti U Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

Uz aplikaciju potrebno je priložiti: CV¹, Kopiju lične karte, dokumenat o prebivalištu, diplomski rad ili potvrda iz poslednje godine nivoa obrazovanja, (svi dokumenti treba da budu kopije).

Nepotpune prijave i one *podnete* nakon isteka roka *neće* biti prihvaćene

U slučaju velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani

Kandidati koji uđu u uži izbor biće intervjuisani na Albanskom jeziku.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038- 200 31 149 ili 200 31 133 od 08:00 – 16: 00 časova.

¹ Uključujući: Broj telefona i elektronsku adresu



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr. 464-60849
Datë: 03.01.2020

